

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5829
E mërkurë, 17 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Kosova kërkon përkrahjen
e Britanisë për procesin e
dialogut me Serbinë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", DUKAGJIN PUPOVCI | FAQE 4 - 5

Ndërrhyrjet politike në Këshillin e Cilësisë mund të sjellin pasoja ndërkombëtare



Eksperti i arsimit, Dukagjin Pupovci, e ka ftuar qeverinë të tërhiqet nga tentimet për të ndikuar në vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se ndërrhyrjet e tilla politike mund të sjellin pasoja në rrafshin ndërkombëtar për Kosovën. Sipas Pupovcit, kjo mund çojë në përjashtimin e Agjencisë së Akreditimit nga Rrjeti Evropian i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë (ENQA). Profesori universitar ka vlerësuar se kryeministri dhe ministrat duhet të tërhiqen nga këto veprime sepse, sipas tij, Kosovës nuk i duhet izolimi i arsimit të lartë nga Evropa. Pupovci ka treguar se vendimin e KShC-së mund ta ankimojnë universitetet dhe jo qeveria. Ai ka theksuar se të rinjtë humbin shumë më tepër nëse studiojnë në një institucion i cili nuk i përmbush standardet e cilësisë sesa nëse orientohen për të studiuar në një institucion tjetër

Veseli u bënë thirrje për njohje vendeve që ende s'e kanë njohur Kosovën

"Kosova është shtet i ri dhe po ecën përpara. Kërkoj nga ju që ta njihni shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Kjo i shërben paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. I shërben edhe miqësisë dhe zhvillimit

të lidhjeve tona në të gjitha fushat e mundshme të bashkëpunimit", ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në hapje të fjalës së tij në Kongresin Amerikan në Uashington | FAQE 7



'Z-Mobile' e dërgon Telekomin te
përmbaruesi për 25 milionë eurot,
FSP-PTK paralajmëron grevë | FAQE 7

AKTUALE



MINISTRIA E MBROJTJES
MERR NË SHFRYTËZIM
AEROPORTIN E GJAKOVËS | F. 7

NORVEGJIA MBËSHKET
KOSOVËN NË PROCESIN
E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE | F. 6

FILLOJNË KORRJE-SHIRJET
NË KOMUNËN E SKENDERAJT
| F. 10

EKONOMI

FERMERËT E KAÇANIKUT
DO TA KENË MBËSHKETJEN E
MBPZHR-së | F. 9

DËSHTON MBLEDHJA E
KOMISIONIT PËR FINANCA,
NUK SHQYRTOHEN RAPORTET
E AUDITIMIT TË POSTËS
DHE TELEKOMIT | F. 9



KULTURË

SHKRIMTARI
PËRBALLË
DIKTATURËS | F. 13

Bedri ISLAMI



SPORT

KOSOVA DEBUTOI
ME HUMBJE NË BOTËROR | F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Basha: Me presidentin Meta folëm për 13 tetorin, zgjedhje për njerëzit

TIRANË, 16 KORRIK - Të martën lideri i PD-së, Lulzim Basha, u prit nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta. Pas takimit edhe me aleatët, në një komunikim me mediet, Basha tha se është njohur nga kreu i Shtetit me qëndrimin për të organizuar më 13 tetor zgjedhje lokale, të përgjithshme dhe presidenciale. "Duke vlerësuar maksimalisht qëndrimin e presidentit, i kam bërë të ditur se zgjed-

hjet e ardhshme duhet të jenë për njerëzit dhe jo për partitë dhe aq më pak për oligarkët. Në këtë funksion opozita është e gatshme të ndërmarrë çdo hap për t'u garantuar shqiptarëve të drejtën e votës", tha Basha.

Ekonomia do të jetë fokusi i ri i opozitës pasi, siç tha edhe vetë Basha, beteja për votën e lirë dhe demokracinë i kanë krijuar hapësirë qeverisë "që t'i

grabisë shqiptarët". "Kemi diskutuar për emergjencën ekonomike ku ndodhet vendi sepse një nga mëkatet më të mëdha, një nga fajet më të mëdha të kësaj bande që na qeveris, është se duke tërhequr opozitën në betejën parimore për demokracinë dhe votën e lirë, ia ka dalë t'i vërsulet Shqipërisë dhe buxhetit të saj, t'i grabisë qytetarët", tha Basha.



Jehona e vizitës së presidentit francez në Beograd

Presidenti francez Emmanuel Macron tha, gjatë qëndrimit në Beograd, se do të organizojë një takim në Paris ndërmjet palëve bashkë me kancelaren gjermane Angeka Merkel, dy javë pasi që një nismë e tillë e të dy udhëheqësve të lartë evropianë dështoi për shkak të qëndrimeve tërësisht të kundërta të palëve

PRISHTINË, 16 KORRIK - Presidenti francez Emmanuel Macron përmbylli vizitën dyditëshe në Beograd, duke paralajmëruar një nismë të re për ripërtëritjen e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai tha, gjatë qëndrimit në Beograd, se do të organizojë një takim në Paris ndërmjet palëve bashkë me kancelaren gjermane Angeka Merkel, dy javë pasi që një nismë e tillë e të dy udhëheqësve të lartë evropianë dështoi për shkak të qëndrimeve tërësisht të kundërta të palëve.

Serbia kushtëzon vazhdimin e bisedimeve të pezulluara që nga nëntori i vitit të kaluar me heqjen e tarifave ndaj mallrave serbe që i vendosi Qeveria e Kosovës në përgjigje të, siç është thënë, fushatës agresive të Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës, ka njoftuar voa.

Presidenti serb Aleksandër Vuçiq tha të martën se pret që në muajin shtator të organizohet një

takim në Paris, ngjashëm me atë që ishte planifikuar të mbahej më 1 korrik.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha në Prishtinë se Kosova nuk do të ulet më në tryezën e bisedimeve me Serbinë pa një kornizë marrëveshjeje për njohje të ndërsjellë në kufijtë ekzistues dhe kritikoi Serbinë dhe një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare, për siç tha, hezitim për ta përfshirë këtë parim në një kuadër të marrëveshjes së mundshme.

"Kjo po i bie që po na këshillojnë të blejmë 'mistrala' (sistem raketor francez). Serbinë po e armatosin me 'Mistral'. Për shembull, Serbia po shkon po blen armë në Rusi. Edhe Franca bëri një kontratë me Serbinë për sisteme raketore e neve po na thuhet nuk mund t'i vendosim emër marrëveshjes që është njohja reciproke në kufijtë ekzistues. Mirë çfarë të bëjmë ne pra? Ne jemi shtet i pavarur, ne nuk kërkojmë asgjë në dialog



pos njohjes reciproke, nëse nuk jeni gati për këtë, është porosi për ne që të armatosemi, pra nuk ka shumë hapësirë këtu në mes, kërkesa në këtë rast e kryetarit të qeverisë ose e Kosovës është shumë bazike: nuk ulemi në tavolinë më pa një kornizë marrëveshjeje që ka emrin njohja reciproke në kufijtë ekzistues, pra nuk kemi pse të ulemi", tha kryeministri Haradinaj. Ai tha se roli i Francës dhe presidentit Macron po rritet dhe një angazhim i tillë "mund ta kthejë Serbinë në tavolinë edhe pa u larguar tarifa, pra mund ta kthejë dhe shpresoj që do të jetë kështu". Haradinaj i cilësoi si këshilla të mira thirrjet e presidentit Macron për kom-

promis mes palëve.

Presidenti serb, Vuçiq, ndërkaq tha në Beograd se presidenti Macron e kupton "peshën e problemit kur flitet për Kosovën dhe se gjërat nuk mund të zgjidhen asisoj që asnjëra palë të mos lëshojë pe në asgjë".

Presidenti serb kërkon një zgjidhje kompromisi dhe ai me bashkëpunëtorët e tij thonë se nuk do ta njohin Kosovën në kufijtë aktualë duke vënë theksin te veriu i Kosovës, ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sërish ngul këmbë në kërkesat për bashkimin me Kosovën të Luginës së Preshevës, një rajon me shumicë shqiptare në jug të Serbisë. Idetë e tilla që, në fakt, u hodhën

një vit më parë, kanë nxitur ndarje të thella në Kosovë e në Serbi, por edhe në komunitetin ndërkombëtar, ndërmjet atyre që do të pranonin çfarëdo marrëveshjeje që arrijnë të dyja palët dhe atyre që druajnë nga efektet që do të kishte një prekje e kufijve në rajonin e Ballkanit.

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është kusht për integrimin e të dyja vendeve në Bashkimin Evropian. Por, presidenti Macron, ndonëse tha se të dyja "shtetet janë evropiane", nuk bëri asnjë premtim për të ardhmen e tyre në bllokun që, sipas tij, duhet fillimisht të reformohet para se të zgjerohet më tej.

Pendarovski: Ndryshimi i kufijve në Ballkan sjell konflikte të armatosura

LUBJANË, 16 KORRIK - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka shprehur qëndrimin e tij kundër ndryshimit të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në një konferencë shtypi nga Sllovenia, presidenti Pendarovski u shpreh se ndryshimi i kufijve mund të çojë në konflikt të armatosur. "Kufijtë duhet të qëndrojnë aty ku janë.

Çdo opsion tjetër mund të krijojë një efekt domino, që mund t'i dëmtojë disa vende në rajon, duke përfshirë Maqedoninë e Veriut", tha presidenti i Maqedonisë së Veriut. Ai shtoi se "ndryshimet e kufijve mund të çojnë madje edhe në konflikte të armatosura".

Marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Kosovës janë tensionuar që

nga viti 2008, kur Prishtina, me mbështetjen e vendeve perëndimore, shpalli pavarësinë nga Serbia. Serbia dhe Kosova u zotuan, në vitin 2013, për një dialog të sponsorizuar nga Bashkimi Evropian, që synon zgjidhjen e një sërë dallimesh, duke përfshirë mosmarrëveshjet territoriale, por pak përparim është bërë në këtë drejtim.



Një delegacion i Britanisë së Madhe ka qëndruar për vizitë në Republikën e Kosovës

Kosova kërkon përkrahjen e Britanisë për procesin e dialogut me Serbinë

Delegacioni i Britanisë së Madhe, i kryesuar nga shefi i Departamentit për Ballkanin Perëndimor, Andrew Page, si dhe zyrtarja e lartë e Sektorit të Analizës në Zyrën për Punë të Jashtme, Susan Laffey, kanë vizituar Kosovën të martën, me ç'rast janë pritur në takime të ndara nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj. Drejtuesit e institucioneve të Kosovës kanë kërkuar përkrahjen e Britanisë për procesin e dialogut me Serbinë. Po ashtu, zyrtarët kosovarë dhe ata britanikë kanë shprehur përkushtimin për ta thelluar bashkëpunimin bilateral ndërmjet dy vendeve



EPOKA E RE Shqipe **HETEMI**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën ka pritur në takim një delegacion britanik të kryesuar nga shef i Departamentit për Ballkanin Perëndimor, Andrew Page, si dhe zyrtarja e Lartë e Sektorit të Analizës në Zyrën për Punë të Jashtme, Susan Laffey, të shoqëruar edhe nga ambasadori anglez në Kosovë, Ruairi O'Connell. Gjatë këtij takimi kryeministri Haradinaj e ka njoftuar delegacionin britanik për progresin e

Kosovës, prioritetet e qeverisë, agjendën integruese të Kosovës, përkushtimin e qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, për zhvillimin ekonomik dhe për çështjet jetike për përmirësimin e jetës së qytetarëve. "Kosova është e përkushtuar që të shtojë bashkëpunimin bilateral me Britaninë e Madhe, në fushën politike dhe atë ekonomike", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Ai e ka falënderuar Britaninë e Madhe për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë dhe vazhdon t'ia japë Kosovës në shumë fusha, në të gjitha etap-

at e shtetndërtimit të saj. Gjithashtu, kryeministri Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e mëtejme të Britanisë për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, në veçanti në procesin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Ndërsa përfaqësuesit e delegacionit britanik kanë vlerësuar përparimin e Kosovës si dhe kanë shprehur zotimin se Mbretëria e Bashkuar do ta vazhdojë angazhimin e saj në Kosovë, duke e mbështetur vendin tonë në procese të rëndësishme dhe në rrugën evropiane.

Delegacioni i zyrtarëve britanikë të martën është pritur në takim edhe nga zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj dhe kryetari i Grupit Parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi. Limaj ka bërë me dije se në këtë

takim është biseduar për zhvillimet aktuale politike në vend, në veçanti për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka ritheksuar se shteti i Kosovës do të flasë njëzëri në këtë proces. "Ne do të angazhohemi që Kosova të flasë me një zë në këtë proces. Këtë qëndrim ia shpalosa delegacionit britanik të kryesuar nga Andrew Page, shef i Departamentit për Ballkanin Perëndimor si dhe Susan Laffey, zyrtare e Lartë e Sektorit të Analizës në Zyrën për Punë të Jashtme", është shprehur zëvendëskryeministri Limaj. Sipas Limajt, për Kosovën është shumë me rëndësi përfshirja sa më e madhe e Britanisë në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë sepse, siç ka thënë ai, kjo i jep kredibilitet dhe siguri procesit. Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Limaj ka vlerësuar se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve është i paalternativë. Ai ka thënë se palët duhet ta gjejnë

formulën për ta arritur marrëveshjen përfundimtare e cila ka për qëllim njohjen reciproke. "Bashkërisht u pajtuam që dialogu mes dy vendeve është i paalternativë dhe se duhet gjetur rrugë deri tek arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes dy vendeve që për epilog do të ketë njohjen reciproke", ka deklaruar zëvendëskryeministri Fatmir Limaj.

Edhe kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, i shoqëruar nga nënkryetari Visar Ymeri dhe nënkryetarja Aida Dërguti, kanë pritur në takim delegacionin britanik. Në këtë takim është diskutuar rreth aktualitetit politik, me fokus në çështjen e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Drejtuesit e PSD-së kanë shpalosur qëndrimet e partisë karshi këtij procesi dhe çështjeve të tjera. Po në këtë takim është theksuar rëndësia e bashkëpunimit dhe takimeve të tjera të kësaj natyre.



Reagon KShC-ja: Vendimet tona të mos përdoren për lojëra politike

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në një deklaratë për medie ka bërë me dije se është i shqetësuar për manipulimin e opinionit publik dhe përdorimin e vendimeve të këtij institucioni për lojëra politike. Në këtë deklaratë është thënë se vendimet e KShC-së janë në funksion të garantimit të cilësisë në arsim dhe mbrojtjes së familjeve dhe fëmijëve të tyre nga programe, institucione me cilësi të kontestueshme dhe larg standardeve evropiane. "KShC-

ja garanton qasje të studentëve në arsim cilësor dhe premtues për zhvillim shoqëror në Kosovë, të krahasueshëm me vendet evropiane. Jemi të përkushtuar të rezistojmë ndaj çdo ndërhyrje në pavarësinë e AKA-së dhe vendimmarrjen e KShC-së. Çdo ndërhyrje të paligjshme nga politika do ta denoncojmë në institucionet e drejtësisë", është thënë në deklaratën për medie të KShC-së.

Më tutje, në këtë deklaratë është theksuar se Institucionet e

Arsimit të Lartë (IAL) që nuk kanë marrë vlerësim pozitiv për akreditim nuk do të mund të regjistrojnë studentë në vitin akademik 2019-2020. "Prandaj, ato nuk do të mbyllen, por do t'i nënshtrohen sërish procesit të riakreditimit institucional. Studentët aktualë vazhdojnë studimet në programet e akredituara. Shpresojmë se këto vendime do të ofrojnë bazë për reflektim dhe veprim të IAL-ve për përmbushjen e standardeve për akreditim", është theksuar



më tutje në deklaratën e KShC-së, duke theksuar më tutje se KShC-ja merr vendime mbi

rekomandimet e ekspertëve sipas mandatit që ka dhe legjislacionit në fuqi.

Flet për "Epokën e re", Dukagjin Pupovci

Ndërhyrjet politike në Këshillin e Cilësisë

Eksperti i arsimit, Dukagjin Pupovci, e ka ftuar qeverinë të tërhiqet nga tentimet për të ndikuar në vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se ndërhyrjet e tilla politike mund të sjellin pasoja në rrafshin ndërkombëtar për Kosovën. Sipas Pupovcit, kjo mund çojë në përjashtimin e Agjencisë së Akreditimit nga Rrjeti Evropian i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë (ENQA). Profesori universitar ka vlerësuar se kryeministri dhe ministrat duhet të tërhiqen nga këto veprime sepse, sipas tij, Kosovës nuk i duhet izolimi i arsimit të lartë nga Evropa. Pupovci ka treguar se vendimin e KShC-së mund ta ankimojnë universitetet dhe jo qeveria. Ai ka theksuar se të rinjtë humbin shumë më tepër nëse studiojnë në një institucion i cili nuk i përmbush standardet e cilësisë sesa nëse orientohen për të studiuar në një institucion tjetër

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Pupovci, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka marrë vendim që tri universiteteve publike, "Ukshin Hotit", "Haxhi Zekës" dhe "Isa Boletinit", dhe katër kolegeje private t'ua heqë akreditimin, duke pamundësuar kështu regjistrimin e studentëve të rinj këtë vit. Si e keni parë këtë veprim të këtij institucioni? Pupovci: Tanimë është publikuar vendimi i plotë i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) dhe po shihet se pikërisht këtyre institucioneve të cilat nuk janë akredituar, u janë akredituar disa programe. Pra, bëhet fjalë për heqjen e akreditimit institucional, jo për akreditimin e programeve. Si do që të jetë, kjo nënkupton se këto institucione nuk mund të regjistrojnë studentë brenda një viti. Unë konsideroj se kjo është një periudhë brenda së cilës ato institucione duhet të bëjnë përpjekje që t'i adresojnë vërejtjet nga raporti i ekspertëve dhe të shohin se si mund të përmirësohen në mënyrë që vitin tjetër të mos i lejojnë veeës të dështojnë edhe një herë në akreditim, sepse pastaj vjen edhe te mbyllja e institucionit. Prandaj, është një sinjal për këto institucione, besoj edhe për të tjerat, se duhet të përmirësohen në standardet e cilësisë. Besoj se ato do ta shfrytëzojnë këtë rast në mënyrën më të mirë të mundshme.

"Epoka e re": Pas publikimit të vendimit të KShC-së, kemi pasur një reagim të kryeministrit i cili ka paralajmëruar se do të ndërhyjë. Çfarë pasoja mund të sjellë kjo?

Pupovci: Këtu bëhet fjalë për një

institucion të pavarur i cili është emëruar nga Kuvendi i Kosovës dhe çdo ndërhyrje e qeverisë në punën e këtij institucioni quhet ndërhyrje politike. Ndërhyrja e tillë mund të sjellë pasoja në rrafshin ndërkombëtar, në rastin konkret do të ishte përjashtimi i Agjencisë së Akreditimit nga Rrjeti Evropian i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë (ENQA), ashtu siç u përjashtua para një viti e gjysmë nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR), që ishte, po ashtu, pasojë e një ndërhyrje tjetër politike të qeverisë. Prandaj, konsideroj se Kosovës nuk i nevojitet që arsimit i lartë i saj të izolohet nga Evropa. Në këtë mënyrë, mendoj se kryeministri dhe ministrat që janë prononcuar në këtë drejtim duhet të tërhiqen nga veprimet e tyre dhe të mos bëjnë hapa të cilat do t'i kushtojnë arsimit të lartë të gjeneratave të reja.

"Epoka e re": Më pas kemi pasur një lloj sqarimi nga ministri i Arsimit, i cili ka deklaruar se KShC-ja ka shkelur vendimin e MASHT-it pasi që nuk është dashur të dalë me vendim para se Agjencia Kundër Korrupsionit të marrë vendim nëse ka pasur konflikt interesi në këtë vendim?

Pupovci: Sa e kam kuptuar unë vendimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili është publikuar në uebfaqen e universitetit, ajo konsideron se fakti që pesë anëtarët vendorë të KShC-së janë nga Universiteti i Prishtinës paraqet një shkelje ligjore, sepse udhëzimi administrativ thotë se maksimumi tre anëtarë mund të jenë nga një universitet, ndërkohë ka ndodhur që dy prej anëtarëve që kanë punuar në institucione të tjera janë punësuar në Universitetin e Prishtinës. Kjo nuk është një sit-



Ë mund të sjellin pasoja ndërkombëtare



uatë që mund ta zgjidhë vetë agjencia, respektivisht Këshilli Shtetëror i Cilësisë, sepse këshilli nuk i emëron ata anëtarë. Kjo është një situatë të cilën duhet ta zgjidhë ministri i Arsimit me Kuvendin. Pra, nëse konsiderojnë se ata anëtarë duhet të shkarkohen, atëherë thjesht duhet t'i shkarkojnë me këtë arsytim, jo me ndonjë arsytim tjetër, sepse ata meqenëse e kanë ndërruar institucionin ku punojnë, e kanë krijuar situatën që pesë veta në KShC janë nga i njëjti institucion. Në rastin konkret, KShC-ja nuk ka marrë vendime që kanë të bëjnë me Universitetin e Prishtinës ku punojnë këta njerëz, por ka marrë vendime që kanë të bëjnë me institucionet e tjera. Prandaj, mendoj se këtu nuk kemi konflikt interesi. Nga ky këndvështrim nuk mund të quhen të paligjshme vendimet e KShC-së. Sigurisht se mund të kontestohen nga aspekti i përmbajtjes së tyre. Mund të thuhet se nuk kanë qenë të drejta, por nuk mund të thuhet se nuk janë të ligjshme.

"Epoka e re": Nuk kanë munguar as ofendimet e kryeministrit ndaj anëtarëve të KShC-së, duke thënë se ata janë mafi. Cili është qëndrimi juaj ndaj këtyre klasifikimeve?

Pupovci: Për fat të keq gjuha e cila po përdoret nga strukturat tona qeverisëse shpeshherë është e papranueshme. E tillë ishte edhe gjuha e kryeministrit sot. Nuk mundet një kryeministër i vendit t'i quajë njerëzit me emra mafi e hajna të pulave, qysh ka ndodhur më herët. Këto janë kualifikime ofenduese dhe unë për asnjërin nga anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë nuk di diçka inkriminuese. Nëse dikush di diçka inkriminuese për ta, ekzistojnë organet e drejtësisë të cilat mund t'i ndjekin ata njerëz nëse kanë bërë diçka me prapavijë. Konsideroj se këtu prapavijë nuk ka pasur. Ndoshta kësaj radhe nuk i janë bindur politikës siç ka qenë rasti i herëve të kaluara kur anëtarët e KShC-së janë vendosur në pozitë që t'i binden politikës. T'i quash ata mafi është me të vërtetë diçka e papranueshme. Një gjë e tillë duhet të dënohet nga opinioni publik.

"Epoka e re": Pra, ju besoni se vendimi i KShC-së ka qenë i drejtë dhe, si i tillë, duhet të mbështetet e jo të ndryshohet?

Pupovci: Mendoj se opinioni publik duhet ta mbështesë pavarësinë e agjencisë për marrjen e vendimeve sepse ky është kusht që Kosova të jetë pjesë e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Ndërkaq vendimin nuk mund ta mbrojë askush, sepse

vendimi edhe mund të jetë i padrejtë. Së pari ende nuk është publikuar raporti i grupit të ekspertëve ku tregohet pse po u refuzohet akreditimi këtyre institucioneve. Pastaj, sigurisht se këto institucione e kanë të drejtën e ankesës, fillimisht në komisionin e ankesave, që herën e kaluar i ka rrëzuar disa vendime të KShC-së përkundër paragjykimëve të njerëzve. Hapi i dytë është gjykata ku mund të ankohen. Mirëpo këtu qeveria nuk ka punë. Pra, është një linjë tjetër brenda së cilës zgjidhen këto mospajtime. Por, të kontestohet autoriteti i agjencisë që të marrë vendime është e papranueshme, sepse po del se jo vetëm kjo agjenci, por edhe agjencitë e tjera kur duan të marrin vendime më të ndjeshme duhet ta konsultojnë qeverinë apo partitë politike. Kjo, faktikisht, e dëmton sistemin.

"Epoka e re": Pse mendoni se po reagon politika kaq fuqishëm ndaj një vendimi të tillë. Arsyet e tyre janë se të rinjtë e Kosovës po mbesim pa u regjistruar në fakultete?

Pupovci: Si duket zgjedhjet nuk janë larg. Sa herë që ka zgjedhje në Kosovë e pëson zakonisht arsimit i lartë. Më herët e ka pësuar me themelimin e universiteteve pa përgatitje paraprake, kurse tash, si duket, duan për ta pësuar me kualifikime demagogjike, se gjoja po humbin të rinjtë. Të rinjtë humbin shumë më tepër nëse studiojnë në një institucion i cili nuk i përmbush standardet e cilësisë sesa nëse orientohen për të studiuar në një institucion tjetër. Pra, këtu nuk është esenca që të rinjtë të studiojnë me çdo kusht në Universitetin e Mitrovicës, të Prizrenit ose të Pejës. Me rëndësi është që shteti t'u garantojë atyre që në institucionin që studiojnë të ketë cilësi. Në këtë rast, shteti nuk po jep garanci të tilla, sepse Agjencia Shtetërore nuk i ka akredituar. Ndërkaq qeveria nuk është ajo që mund ta di më mirë se Agjencia e Akreditimit nëse këto institucione i plotësojnë kushtet e cilësisë apo jo. Prandaj, kjo po më duket si lojë elektorale e cila është krejtësisht e panevojshme. Regjistrimet e tanishme në UP kanë treguar se kanë mbetur plot vende të lira, po ashtu janë edhe tri universitete të tjera publike për ata që duan të studiojnë pa pagesë. Në këtë mënyrë, mendoj se të rinjtë kanë zgjedhje për të studiuar. Ndërkohë, deri në vitin tjetër sigurisht se duhet të rregullohen punët që edhe këto tri universitete të mund pranojnë studentë. Ky do të jetë një mesazh edhe për të tjerët që të kenë kujdes për cilësinë që ofrojnë.

Norvegjia mbështet Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të martën në një takim lamtumirës ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad.

Zëvendëskryeministri Pacolli ka falënderuar ambasadorin për mbështetjen e palëkundur të shtetit dhe popullit norvegjez nëpër të gjitha proceset që ka kaluar Kosova dhe populli i saj. Me këtë rast, ambasadori Per Strand Sjaastad ka përgëzuar zëvendëskryeministrin Pacolli për punën e palodhshme që po bën për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Ambasadori dhe zëvendëskryeministri janë zotuar për rritjen e përpjekjeve për thellimin dhe bashkëpunimin dypalësh me fokus të veçantë në diplomacinë publike, energji, investime si dhe vazhdimin e ofrimit të përkrahjes

për trajnimin e shërbyesve civilë për procesin e integritit evropian.

Edhe ministrja e Integritit Evropian, Dhurata Hoxha, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad. Me këtë rast, ajo ka vlerësuar angazhimin e ambasadorit për thellimin e bashkëpunimit dhe përkrahjen e gjithanshme të Norvegjisë për proceset integruese. "Marrëdhëniet tona kanë qenë dhe janë shembullore dhe kësaj i kemi kontribuar shumë ambasadorë. Ju kemi thëlluar dhe zgjeruar bashkëpunimin duke e bërë rrugën tonë në procesin integrues më të lehtë dhe më të avancuar. Gjithsesi, rruga jonë, miqësia jonë nuk do të ndalen me përfundimin e mandatit tuaj në republikën tonë. Miqësia si ajo e ambasadorit Per Strand Sjaastad është vlerë për Kosovën", ka deklaruar ministrja Hoxha.

Çelaj me studentët çekë: BE-ja nuk duhet të vonohet për procesin integrues të rajonit

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Integritit Evropian, Lirak Çelaj, ka pritur të martën në takim grupin e studentëve çekë me të cilët ka diskutuar për zbatimin e reformave, procesin integrues dhe liberalizimin e vizave. Çelaj ka thënë se të rinjtë janë vlera dhe aset më i çmuar i vendit tonë. Sipas tij, ata kanë nevojë për hapësirë veprimi, për bashkëngjitje dhe qasje të lehtësuara me vlerat evropiane, me moshatarët e vet në arsim dhe ngritjen e profesionalizmit të vet. "Pengesat në lëvizjen e lirë për qytetarët tanë, në veçanti për të rinjtë tanë, janë të meta të

cilat duhet të mënjahen dhe presim nga Këshilli i Ministrave të trajtojë këtë çështje të rëndësishme për qytetarët tanë. Diaspora jonë është shumë e fuqishme dhe kjo ndikon edhe në raportet e tjera, sikur është aftësimi i të rinjve tanë dhe investimet, marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe aspekte të tjera që ndikojnë në avancimin e vendit dhe qytetarëve tanë", ka thënë Çelaj.

Studentët çekë u interesuan për progresin dhe procesin e reformave, aspektet e zhvillimit ekonomik, fushat e investimeve dhe arsimimit, çështjet ambientale dhe ndaljen e "brain gain", si çështje problematike e të gjitha shteteve.

Çelaj ka potencuar se vlerat



integruese dhe përcaktimi konsensual për të ardhmen evropiane të Kosovës bëjnë që të bëhet përkushtim i shtuar për ta ndaluar ikjen e të rinjve apo

"brain gain", duke u fokusuar për vonesat e padrejta për procesin integrues.

Zëvendëskryeministri Çelaj ka thënë se vonesat mund të sjellin

ndikime të padëshirueshme nga rreziqet globale të ndryshme, nga vlerat dhe përcaktimet integruese euroatlantike të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Ministri Tahiri: Së shpejti nis rekrutimi për përmbarues privatë



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të martën në takim presidentin e Unionit Ndërkombëtar të Përmbaruesve, Mark Schmitz, i cili po qëndron në Republikën e Kosovës me rastin e shënimit të pesëvjetorit të përmbarimit privat në Kosovë.

Ministri Tahiri e njoftoi Schmitzin se profesionet e lira ligjore, në mesin e të cilave edhe përmbarimi, përbëjnë sis-

tem që i përgjigjet një modeli dhe standardi më të ardhme të sigurt. Tahiri ka potencuar se së shpejti do të publikohen edhe konkurset për t'i mbushur pozitat vakante për përmbarues privatë. Sipas ministrit Tahiri, këto pozita do të shpallen në bazë të analizave të bëra, sidomos për ato zona gjeografike ku nuk ka prani të mjaftueshme për t'i ofruar shërbimet përmbarimore, duke përfshirë edhe në disa komuna të banuara krye-

sisht nga komunitetet joshumicë.

Ndërsa Schmitz ka përgëzuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Odën e Përmbaruesve Privatë për të arriturat dhe kontributin e përmbarimit privat në fuqizimin e sistemit të drejtësisë. Ai u zotua për avancimin e bashkëpunimit në mes të Unionit Ndërkombëtar të Përmbaruesve dhe Odës së Përmbaruesve Privatë të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë në forumin e liderëve parlamentarë të organizuar nga Kongresi Amerikan në Uashington

Veseli u bënë thirrje për njohje vendeve që ende s'e kanë njohur Kosovën

"Kosova është shtet i ri dhe po ecën përpara. Kërkoj nga ju që ta njihni shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Kjo i shërben paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. I shërben edhe miqësisë dhe zhvillimit të lidhjeve tona në të gjitha fushat e mundshme të bashkëpunimit", ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në hapje të fjalës së tij në Kongresin Amerikan në Uashington



Johnson, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet politike në vend dhe rajon, me theks të veçantë për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi.

Senatori Johnson ka thënë se ShBA-ja gjithmonë përkrah Kosovën në rrugën e saj drejt integritetit euroatlantike. "Është me rëndësi që Kosova dhe Serbia t'i kthehen dialogut sa më parë dhe ta arrijnë marrëveshjen e obligueshme. Rasti i Maqedonisë dhe Greqisë është shembull që duhet ndjekur se kur ka vullnet politik mund të arrihet marrëveshje përfundimtare", ka thënë senatori Johnson.

Ndërsa kryeparlamentari Veseli ka falënderuar senatorin Johnson për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së për Republikën e Kosovës. "Republika e Kosovës dhe Serbia duhet të arrijnë marrëveshje të obligueshme për njohjen reciproke. Ky është opsioni i vetëm që siguron paqe dhe stabilitet të përhershëm në rajon. Pavarësisht prej dallimeve të brendshme, në raport me dialogun, Republika e Kosovës është e gatshme për fazën finale të dialogut", ka thënë Veseli.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

WASHINGTON, 16 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, po merr pjesë në forumin e liderëve parlamentarë të organizuar nga Kongresi Amerikan në Uashington. Në hapje të këtij forumi, ku po marrin pjesë krerë parlamentesh të shumë vendeve, por edhe nga ato që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, Veseli ka përcjellë një mesazh, nëpërmjet të cilit u ka kërkuar atyre që ta njohin shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. "Kosova është shtet i ri dhe po ecën përpara. Kërkoj nga ju që ta njihni shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Kjo i shërben paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. I shërben edhe miqësisë dhe zhvillimit të

lidhjeve tona në të gjitha fushat e mundshme të bashkëpunimit", ka thënë Veseli në hapje të fjalës së tij në Kongresin Amerikan.

Në këtë forum të organizuar nga Kongresi Amerikan, bashkë me kryeparlamentarin Veseli po marrin pjesë edhe deputetët e opozitës, Mimoza Kusari-Lila dhe Avdullah Hoti. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar në Uashington senatorin demokrat Gary Peters dhe kongresmenin republikan Vern Buchanan, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon si dhe për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe ShBA-së.

Gjatë takimit me senatorin Gary Peters, i cili është anëtar i Komitetit për Siguri Kombëtare në ShBA, kryeparlamentari Veseli

foli për të ardhmen e ushtrisë së Kosovës dhe bashkëpunimin e saj me ushtrinë amerikane.

Senatori Peters, nga ana e tij, shprehu mbështetjen për të ardhmen e ushtrisë së Kosovës drejt anëtarësimit në NATO. Ndërsa në takim me kongresmenin Vern Buchanan, kryeparlamentari Kadri Veseli ka diskutuar për çështjet tregtare dhe për nxitjen e investimeve amerikane në Kosovë.

Kryeparlamentari Veseli tha se Kosova ka potencial të zhvillimit ekonomik dhe tashmë ka infra-

strukturë moderne për investitorë të jashtëm. Ndërsa kongresmeni Vern Buchanan ka theksuar se është duke u interesuar që të nxisë kompani amerikane për të investuar në Kosovë në sektorë të ndryshëm.

Veseli me senatorin Ron Johnson: Kosova e gatshme për fazën finale të dialogut

Gjatë vizitës në ShBA, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar në Senatën Amerikan senatorin Ron

Ministria e Mbrojtjes merr në shfrytëzim Aeroportin e Gjakovës



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Në Ministrinë e Mbrojtjes të martën është mbajtur ceremonia e dorëzimit-pranimit të Aeroportit të Gjakovës për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në ceremoni morën pjesë dy komisionet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Kohë më parë, me vendim të Qeverisë së Kosovës, është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për marrjen në shfry-

tëzim, me kohë të pacaktuar, të ndërmarrjes publike "Aeroporti i Gjakovës" për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Komisionet e të dy ministrive, pas vlerësimit dhe regjistrimit të pajisjeve brenda hapësirës së Aeroportit, kanë kompletuar dokumentacionin përkatës dhe përcjelljen e të gjitha procedurave për dorëzimit-pranimin e Aeroportit.

Nënshkrimin e dorëzimit-pranimit të Aeroportit të Gjakovës,

në praninë e të dy komisioneve, e bënë: Filloreta Gashi, kryesuese e Komisionit të MZHE-së dhe nënkoloneli Mentor Zejnullahu, drejtor i Drejtorisë të Logjistikës në Ministri të Mbrojtjes.

Nga momenti i nënshkrimit të këtij procesverbali, respektivisht të pranimit-dorëzimit nga të dy komisionet, NP "Aeroporti i Gjakovës" kalon në menaxhim dhe administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Kosova do ta shtojë dinamikën e zbatimit të MSA-së dhe të projekteve të BE-së

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Ministria e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha, ka prituri të martën në takim shefin e Seksionit të Bashkëpunimit të Bashkimit Evropian (BE) me Kosovën, Luigi Brusa, me të cilin ka diskutuar për fuqizimin e bashkëpunimit.

Ministria Hoxha ka theksuar se një nga sferat më të rëndësishme të bashkëpunimit është ngritja dhe aftësimi i kuadrit. "Një nga programet më të frytshme të këtij bashkëpunimi me BE-në

është ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe shembull për këtë është Skema Young Cell, e cila ka zgjuar interesim të madh në mesin e të rinjve. Programi ka dëshmuar vlefshmëri për institucionet, duke u bërë nivel i lakmueshëm për të rinjtë dhe integrimin e tyre në institucione pas shkollimit. Ne kemi edhe shumë projekte të cilat përafrojnë vendin tonë me vlerat evropiane nëpërmjet fondeve të IPA-s dhe fondet e tjera për procesin integruar", ka thënë ministria

Hoxha, duke shtuar se institucionet e Kosovës me përkushtim janë duke zbatuar MSA-në, reformat nga agenda evropiane dhe reformat e tjera.

Ndërkaq shefi i Seksionit të Bashkëpunimit të Bashkimit Evropian me Kosovën, Luigi Brusa, ka vlerësuar lart përkushtimin e ministres Hoxha për zbatimin e MSA-së dhe të ERA-s, duke rikonfirmuar gatishmërinë e asistencës për programet e rëndësishme në procesin integruar. Hoxha dhe Brusa u pajtu-



an që të shtohet dinamika e zbatimit të MSA-së, ERA-s dhe projekteve të financuara nga BE-ja

të cilat janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe mirëqenien e tyre.

Kompania "Z-Mobile" e ka dërguar te përmbaruesi Telekomit e Kosovës për ta ekzekutuar vendimin e Arbitrazhit për pagesën 25 milionë euro. Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka thënë se në këtë gjendje në të cilën ndodhet Telekomit, gjasat janë minimale për të kryer një transaksion të kësaj vlere. Ndërkaq Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (FSP-PTK) ka paralajmëruar grevë në rast se nuk do të plotësohen kërkesat e tyre deri më 22 korrik



'Z-MOBILE' E DËRGON TELEKOMIN TE PËRMBARUESI PËR 25 MILIONË EUROT, FSP-PTK PARALAJMËRON GREVË

**EPOKA
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka njoftuar se kanë pranuar propozim përmbarimin nga kreditori "Dardafon.net" LLC (Z-Mobile). Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Telekomit i Kosovës në cilësinë e debitorit i obligohet kreditorit me 25.000.000 euro (njëzetepesë milionë euro), vlerë kjo që pritet të saktësohet pas ekspertizës financiare, ku pritet të kalkuloohen edhe kamatat.

Istrefi ka thënë se në këtë gjendje në të cilën ndodhet Telekomit gjasat janë minimale për të kryer një transaksion të kësaj vlere. "Telekomit i Kosovës njofton të gjitha palët e interesit dhe vetë 'Dardafon.net' (Z-Mobile), se në këtë gjendje në të cilën ndodhet, gjasat janë minimale për të kryer një transaksion të kësaj vlere. Telekomit i Kosovës do t'i ndjekë të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore që të prapësohet ky propozim përmbarim. Po ashtu, do të njoftohet edhe në mënyrë zyrtare vetë aksionari për këtë rast", ka thënë Istrefi.

Ai ka thënë se veprimet e ndërmarra nga ana e "Dardafon.net" janë të njëanshme dhe të paanalizuara për efektet që mund të

kenë. "Si të tilla janë të papranueshme për Telekomit e Kosovës, aq më tepër në kohën kur është duke u biseduar në mirëbesim për mundësinë e të qenit partner edhe në të ardhmen, kuptohet duke respektuar MSA-në ekzistuese deri në skadim të plotë", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit, Bedri Istrefi.

Ai ka theksuar se një akt i tillë do të krijonte një situatë gati të paimagjinueshme dhe rrjedhimisht një kolaps në operime, humbje të besimit ndaj partnerëve, furnitorëve dhe klientëve të Telekomit të Kosovës. "Pasiguria rreth të ardhmes së Telekomit të Kosovës do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë te vetë punëtorët, të cilët demotivimin do ta reflektojnë në krijimin e një krize të brendshme, e që lidhet zinxhir edhe me vetë gjendjen sociale dhe ekonomike në Kosovë. Pasiguria dhe paqëndrueshmëria e Telekomit të Kosovës nënkupton se efekti negativ i këtij veprimi është për keqardhje dhe me pasoja të pariparueshme", ka thënë Istrefi.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka komentuar vendimin e "Z-Mobile"-s për ta dërguar te përmbaruesi Telekomit e Kosovës. Ai ka thënë se është i informuar për këtë, por ky nuk është vendim final. Sipas Haradinajt, pala në këtë rast, partneri i deritashëm, e dërgon në



Dështon mbledhja e Komisionit për Financa, nuk shqyrtohen raportet e auditimit të Postës dhe Telekomit

**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 KORRIK - Në mungesë të kuorumit ka dështuar sot të mbahet mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ku në rend dite ishte shqyrtimi i raportit të Auditimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës.

Kryetari i këtij komisioni, Driton Selmanaj, ka thënë se në mungesë të kuorumit nuk mund të mbahet mbledhja. Sipas tij, vetëm anëtari Avdullah Hoti ka dhënë një informatë zyrtare për mungesën e tij, ndërkaq të tjerët nuk kanë

dhënë asnjë arsyetim. "Unë kam pasur vetëm një informatë zyrtare prej Avdullah Hotit që nuk do të jetë i pranishëm, ndërkaq për të tjerët nuk kam asnjë informatë. Kjo tregon se shumë çështje të rëndësishme siç është Posta, Telekomit dhe Ujësllësi Prishtina, për të cilat kemi çfarë të diskutojmë mjaft, ku raporti i Zyrës së Auditorit është negativ për të gjithë këto institucione. Në mungesë të deputetëve ne jemi të detyruar ta mbyllim këtë mbledhje. Këtë mbledhje po e shtyjmë për të premtën në orën 10:00", ka thënë Selmanaj.

Ndaj kësaj deklarate ka reaguar

kryeshefi i Postës, Sejdi Hoxha, i cili ka kërkuar që mos të paragjykohe çështjet para se të dalin në diskutim. "Për hir të korrektësisë të kryetarit, meqenëse nuk e diskutuam raportin e auditimit, nuk është mirë të japim paragjykimë para se të diskutohen këto çështje në komision", ka thënë Hoxha. Pas kësaj deklarate ka reaguar Driton Selmanaj, duke i thënë se mund të flasë vetëm kur t'ia japë fjalën ai sepse, siç ka thënë Selmanaj, nuk është në objekt të Postës, por në objektin e Kuvendit. Ndërkaq, kryeshefi i Postës, Sejdi Hoxha, i tha Selmanajt se as ai nuk është në gjykatë këtu.



Fermerët e Kaçanikut do ta kenë mbështetjen e MBPZHR-së

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes masave të shumta përkrahëse, do ta vazhdojë mbështetjen e veprimtarive bujqësore në Komunën e Kaçanikut. Kështu është shprehur ministrja e MBPZHR-së, Dijana Ziviq, gjatë takimit që ka pasur të martën me nënkryetarin e Komunës së Kaçanikut, Ylber Bajra, ku është biseduar për zhvillimet e

përgjithshme në sektorin e bujqësisë në këtë komunë. Me këtë rast, ministrja Ziviq e ka njoftuar atë se tashmë afati për aplikim për pagesa të drejt-përdrejta dhe projektet e zhvillimit rural është mbyllur dhe shumë shpejt ajo tha se do të fillojnë edhe vlerësimet e aplikacioneve për programet mbështetëse. Ajo ka theksuar se mbështetje në këto programe do të gjejnë edhe fer-

merët e kësaj komune, të cilët do t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga MBPZHR-ja. Nga ana e tij, nënkryetari i Kaçanikut, Ylber Bajra, e ka falënderuar ministren për gatishmërinë për përkrahjen e mëtejme të sektorit të bujqësisë në këtë komunë. Po ashtu, nënkryetari Bajra e ka njoftuar ministren edhe për projektet e kësaj komune për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.



përmbaram Valën, kjo e fundit i shfrytëzon elementet ligjore dhe është herët të japë përgjigje. "Unë e respektoj vendimin e menaxhmentit për qëndrimin që ka marrë. Do ta përkrahim që ta zhvillojë Telekomin. Vala nuk e ka mohuar asnjëherë borxhin, por ka kërkuar pagesë në mënyra të tjera. Borxhi është vështirë i shmangshëm, por nuk ndikon në bankrotimin e aktivitetit të Valës", ka thënë të martën Haradinaj.

Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (FSP-PTK) ka paralajmëruar grevë në rast se nuk do të plotësohen kërkesat e tyre deri më 22 korrik. "FSP-PTK tashmë është përgatitur për t'u përballur me situatën e fundit të krijuar në Telekomin e Kosovës. Pas të gjitha paralajmërimeve tona të drejtuara menxhmentit të Telekomit të Kosovës dhe qeverisë, si përmes petitionit të marsit të këtij viti ashtu edhe përmes protestës së qershorit, FSP-PTK i ka treguar hapat e saj në kundërshtim të çfarëdo kontrate të re me 'Z-Mobile'. Lidhur me këtë situatë, kuvendi i FSP-PTK më 12 korrik ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme, ku ka analizuar edhe tri raportet profesionale të cilat njëzëri dokumentojnë dëmet afër 200 milionë euro që Telekomit i Kosovës i ka pësuar nga kontrata dhjetëvjeçare me 'Z-Mobile', si:

analizën e kompanisë 'Mazars', raportin e Auditorit të Përgjithshëm për Telekomin e Kosovës dhe raportin e ekspertëve të Valës të angazhuar nga sindikata", është thënë në komunikatën e FSP-PTK.

Sipas kësaj komunikate, bazuar në këto të dhëna dhe bazuar në zotimet e saj për ta mbrojtur me çdo kusht interesin e Tekomit të Kosovës, kuvendi i FSP-PTK ka dalë me kërkesa të qarta ndaj menaxhmentit të Telekomit të Kosovës dhe Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës, si dhe i ka bërë publike hapat e mëtutjeshëm që sindikata do t'i ndër-marrë në kundërshtim të çfarëdo kontrate me "Z-Mobile". "Nëse deri më 22 korrik nuk publikohet njoftimi kundër çfarëdo kontrate të re me 'Z-Mobile', atëherë më 23 korrik FSP-PTK do ta aktivizojë këshillin e saj grevist. Nëse kërkesa jonë nuk plotësohet, më 29 korrik fillon greva e përgjithshme e FSP-PTK, gjatë së cilës do të vazhdojmë t'i kryejmë të gjitha obligimet tona për t'u ofruar shërbime konsumatorëve tanë të Valës, por pas datës 30 korrik nuk do t'u ofrohet më asnjë shërbim konsumatorëve të 'Z-Mobile'. Për të gjitha konsekuencat e mundshme si pasojë e grevës, FSP-PTK nuk do të jetë përgjegjëse", është thënë në komunikatën e FSP-PTK.

Fillojnë korrje-shirjet në Komunën e Skenderajt

SKENDERAJ, 16 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se në këtë komunë ka filluar procesi i korrje-shirjeve. Me këtë rast, ai ka uruar

bujqit për një fillim të mbarë dhe një fund të bereqetshëm të këtij procesi. Sipas Jasharit, sa më shumë që tokat të punohen aq më shumë do të ketë mbështetje. "Fillim të mbarë e

fund të bereqetshëm të korrje-shirjeve, për gjithë bujqit e komunës sonë, të fushatës së sivjetme ku po marrin pjesë rreth 100 autokombajna për korrjen e 6 000 hektarëve me

grurë, 250 hektarëve me elb dhe 120 hektarëve me thekër. Sa më shumë që tokat tona të punohen, aq më shumë mbështetje do të ketë", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".



Haradinaj: Komuna e Suharekës po dëshmon një dinamikë të hovshme zhvillimore



SUHAREKË, 16 KORRIK (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka vizituar të martën Komunën e Suharekës, për ta parë nga afër përparimin e kësaj komune, në infrastrukturë dhe dinamizim të prodhimit vendor.

Haradinaj dhe kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj, kanë diskutuar për bashkërendimin e veprimeve të dy niveleve të qeverisjes për tërheqjen e investimeve të jashtme, për avancimin e lig-

jeve dhe akteve nënligjore që janë të nevojshme dhe mungojnë si dhe në kthimin e pronave nga AKP në komuna për zhvillim ekonomik lokal. "Me 164 biznese prodhuese, 2 497 biznese aktive, Suhareka ka potencial zhvillimi dhe përkrahja e Qeverisë në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të kësaj komune nuk do të mungojë asnjëherë", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri ka vizituar edhe fabrikën e këpucëve "Solid", ku

ka parë nga afër cilësinë e lartë të prodhimeve të saj. Ai ka thënë se është impresionuese fakti që kompania "Solid" ka një qarkullim vjetor prej 3.2 milionë eurosh dhe 249 punëtorë. "Qeveria e vendit është e përkushtuar që t'i përkrahë prodhuesit vendorë duke thelluar reformat fiskale, lehtësirat doganore për teknologji si dhe duke eliminuar barrierat administrative me të cilat ballafaqohen ata", ka thënë Haradinaj.

Akreditohet programi i studimit Matematikë Arsimore në Universitetin 'Kadri Zeka'

GJILAN, 16 KORRIK (ER) - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) ka akredituar programin e studimit Matematikë Arsimore të Fakultetit të Ri, të Shkencave Aplikative. Tani Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan iu shtua edhe një njësi e re akademike, Fakulteti i Shkencave Aplikative.

Me këtë rast, rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, ka thënë se me këtë fakultet dhe program të ri synojnë që ta përmbushim mungesën arsimtarëve të matematikës në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë.

Kështu, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) më

18 qershor dhe 15 korrik mbajti mbledhjet e saj nr. 73 dhe 74. Në kuadër të pikave të rendit të ditës u shqyrtuan raportet finale për nivelin institucional dhe atë të programeve të studimit, të hartuara nga panelet e ekspertëve ndërkombëtarë. Mbi këtë bazë KShC i AKA-së mori vendimet mbi akreditimin e IAL-ve dhe programeve të tyre të studimit.



Mitrovicasi fiton medaljen e artë në hedhjen e gjyles në garat ballkanike



MITROVICË, 16 KORRIK (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur në takim talentin e atletikës, Muhamet Ramadani, i cili ishte i shoqëruar me trajnerin e tij nga klubi i atletikës "Mitrovica", Shaban Ramadani.

Talenti i atletikës, Muhamet Ramadani, e fitoi medaljen e artë në hedhje të gjyles prej 19.31 metrash, në Stamboll të Turqisë, ku morën pjesë edhe 20 shtete të tjera, me ç'rast është shpallur

kampion ballkanik në kategorinë e juniorëve.

Në këtë takim nënkryetari Mujka ka përgëzuar sportistin mitrovicë Muhamet Ramadani për sukseset e arritura në arenën ndërkombëtare, i cili ka fituar medaljen e artë në Kampionatin Ballkanik U-18 në hedhjen e gjyles.

Gjatë këtij takimi nënkryetari Mujka dhe trajneri Ramadani u morën vesh që Komuna e Mitrovicës të ndërtojë një fushë të

vogël sipas normave ndërkombëtare për hedhje të gjyles, pasi që stadiumi "Adem Jashari" është në renovim dhe kjo fushë të ndërtohet afër Liqenit Akumulues në fshatin Suhodoll.

Nënkrjetari i komunës, Faruk Mujka, ka ofruar mbështetjen e tij, duke i siguruar ata që komuna do t'i marrë parasysh të gjitha kërkesat pasi është interes i përbashkët rregullimi i infrastrukturës sportive për klubet dhe të rinjtë e qytetit.

MPJ dënon dëmtimin e varrezave ortodokse në Lipjan

LIPJAN, 16 KORRIK (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës përmes një komunikate për media ka dënuar dëmtimin e varrezave ortodokse serbe në Komunën e Lipjanit, duke thënë se "incidenti në fjalë është kundër interesave të Kosovës dhe se autoritetet do të


bëjnë të pamundurën që raste të këtilla të mos përsëriten". "Ministria e Punëve të Jashtme kërkon nga organet e rendit dhe të hetuesisë të bëjnë gjithçka që është e mundur për t'i zbuluar dhe nxjerrë përpara drejtësisë autorët e këtij incidenti kriminal. Për Republikën e Kosovës,

bashkëjetesa, raportet dhe harmonia ndëretnike janë të shenjta", thuhet në komunikatë. Më 14 korrik Policia e Kosovës ka njoftuar se është duke kryer hetime pas njoftimeve se "janë dëmtuar disa gurë të varrezave ortodokse serbe" në Komunën e Lipjanit.



Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (2)

Bashkimi i bërthamave të ciklonit dhe tornados elektromagnetike



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Forca tërheqëse e bërthamës së ciklonit të tokës e ka tërhequr rreth vetes bërthamën e tornados elektromagnetike e cila ishte më afër. Në këtë mënyrë, pas një kohe, bërthama e tornados elektromagnetike përfundon në brendësi të sferës ferromagnetike me rreze prej 3846 km, në qendër të së cilës ndodhet bërthama e ciklonit.

Me faktin se bërthama e ciklonit tokësor ka të njëjtin element të përbashkët (aX) me bërthamën e tornados elektromagnetike, atëherë gjatë reaksionit bërthama e tornados elektromagnetike përfundon në bërthamën e ciklonit tokësor duke e formuar një bërthamë të vetme të dy fenomeneve (shih figurën 5).

Lindja e rymës elektrike dhe fushës magnetike

Valët që burojnë nga bërthama e tornados elektromagnetike në brendësi të sferës ferromagnetike të tokës i përziejnë elementet ferromagnetike brenda sferës, përkatësisht nikelin dhe hekurin. Me faktin se lartësia e tornadove përgjatë boshtit (y) është shumë më e madhe se gjerësia e saj në drejtim të boshtit (x), prandaj edhe përzjerja e elementeve të hekurit (Fe) dhe nikelit bëhet në formën cilindrike.

Prania e tornados elektromagnetike në një formë a tjetër e krijon një rymë elektrike, e cila qarkullon përgjatë formës cilindrike të tornados elektromagnetike.

Kjo rymë elektrike mund të krijohet gjatë përzjerjes së metaleve të nikelit dhe hekurit (Fe) ashtu siç mendohet sot, apo mund të krijohet gjatë fërkimeve të ndryshme, gjatë rrotullimeve ekstreme të tornados elektromagnetike brenda bërthamës së tokës. Tani për tani është mjaft vështirë të dihet se cili është burimi i kësaj rymë elektrike, por sido që të jetë, nga kjo rymë elektrike formohet fusha magnetike e tornados. Për këtë arsye, tornadoja është burim i rymës elektrike nga e cila krijohet fusha magnetike, për këtë arsye e merr emrin bërthama e tornados elektromagnetike.

Tornadoja elektromagnetike mund të ketë formën e cilindrit të drejtë apo të lakuar, si dhe mund të ketë çfarëdo këndi brenda trupave qiellorë (shih figurën 6).




Fig 5

Forcat e veprimit të tornados elektromagnetike në planetin e tokës

Siç po shihet, brenda strukturës së brendshme të tokës njëkohësisht veprojnë dy forca: Forca e parë është forca e ciklonit që rrotullon planetin e tokës rreth boshtit të vetme një shpejtësi këndore ω , kurse ky bosht quhet boshti gjeografik i rrotullimit të tokës kurse; Forca e dytë është forca e tornados elektromagnetike e cila rrotullohet brenda ciklonit me shpejtësi këndore ω , nga e cila krijohet rryma elektrike dhe fusha magnetike (shih figurën 7). Vlen të theksohet se shpejtësia këndore e tornados elektromagnetike ω , është shumë here më e madhe se shpejtësia këndore e rrotullimit të Tokës, prandaj tornadoja konsiderohet si një robot që rrotullohet brenda një statori, princip i njëjtë me gjeneratorët.

Fusha magnetike e tokës, eksperiment i parë

Duke u bazuar në argumentin e lartpërmendur, ku tornadoja elektromagnetike gjatë rrotullimeve me shpejtësi ω brenda ciklonit e formon fushën magnetike, atëherë forma e këtij dipoli magnetik brenda strukturës së brendshme të tokës, e merr formën e një cilindri magnetik nga i cili buron fusha magnetike. Për ta ndërlidhur këtë fenomen, le ta marrim një magnet në formë cilindrike, i cili posedon një fushë magnetike ku vlera e intensitetit të fushës magnetike në të dy polet e magnetit (N) dhe (S) më një ndryshim të vogël arrin vlerën e 320 mT. Kurse vlera e intensitetit të fushës magnetike në mes të magnetit ka vlerën e 210 mT (shih figurën 8).

Nga magnetizimi i dimë se vijat e fushës magnetike burojnë nga poli magnetik i veriut (N), dhe hyjnë në polin magnetik të jugut (S). Nëse nga cilado anë afrojmë afër cilindrit, sfera apo grimca nga materiali i hekurit (Fe), ato njëkohësisht do të magnetizohen dhe do tërhiqen nga magneti cilindrik.

Eksperimentalisht do të vërtetohet se sferat apo grimcat e hekurit (Fe) nuk do të qëndrojnë rreth mesit të magnetit, por të gjitha do të përfundojnë vetëm në polet magnetike të atij magneti, qoftë




Fig 6




Fig 7




Fig 8




Fig 9




Fig 10




Fig 11




Fig 12




Fig 13

në polin magnetik të veriut (N) apo polin magnetik të jugut (S). Por eksperimentalisht vërtetohet se nga poli magnetik i veriut (N) grimcat e hekurit anojnë më shumë (shih figurën 9).

Vërtetim

Bazuar në këtë eksperiment të thjeshtë që mund të vërtetohet në çdo kohë, mund të themi se ngjashëm edhe në sferën ferromag-

netike që ndodhet në strukturën e brendshme të Tokës ndodhë i njëjti fenomen, me ç'rast cilindri magnetik i formuar nga tornadoja elektromagnetike, gradualisht dhe kohë pas kohe të gjithë materialin ferromagnetik përkatësisht hekurin e katër heqë nga anët anësore, dhe e bartë në polin magnetik të veriut (N) me shumë, dhe polin magnetik të jugut (S) ashtu siç shihet në figurën 10.

Nëse kemi një dipol magnetik brenda tokës që e shkakton fushën magnetike, dhe nëse hekuri ndodhet në gjendje likide, ai gjithsesi do të bartet nga të gjitha anët në polet magnetike të tokës. Bazuar në këtë formë eksperimentale, mund të konkludojmë se struktura e brendshme reale e tokës, ndryshon tërësisht nga struktura e tanishme që njihet dhe pranohet nga të gjithë shkencëtarët e të gjitha kohërave duke përfshirë edhe NASA-n, si agjencinë më të fortë për zbulime shkencore.

Në bazë të këtij eksperimenti, mund të themi se, absolutisht nuk është e vërtetë se bërthama e brendshme e tokës me rreze 1216 km, është e përbërë nga hekuri dhe një sasi e vogël e nikelit, si dhe rreth 10 për qind elemente të lehta si dhe absolutisht nuk është e vërtetë se bërthama e jashtme e tokës me rreze prej 2270 km, përbëhet kryesisht nga një përzjerje ndërmjet hekurit (Fe) dhe nikelit, prej të cilës përzjerje krijohet rryma elektrike dhe fusha magnetike, kurse shtresat e tjera të tokës le të mbesin ashtu siç janë mbështjellësi i brendshëm apo manteli i brendshëm i tokës me rreze 2185 km dhe mbështjellësi i jashtëm apo manteli i jashtëm, së bashku me sipërfaqen me rreze nga 0 deri në 700 km.

Prandaj brenda strukturës së brendshme të tokës, apo brenda tornados elektromagnetike ndodhet vetëm dipoli magnetik në formë cilindrike, por jo cilindër drejtëvijor, por i lakuar (shih figurën 6 dhe 11).

Prandaj struktura e brendshme e tokës në bazë të këtyre të dhënave merr një formë tjetër me elemente përbërëse ashtu siç shihet në figurën 12.

Përfundim

Brenda strukturës së brendshme të tokës, Diellit, Jupiterit... dhe të secilit trupë qiellorë rreth të cilit rrotullohen trupa të tjerë qiellorë, ka një cilindër qoftë drejtëvijorë apo i lakuar të përzjerjeve hekur-nikel, nga e cila përmes tornados elektromagnetike formohet rryma elektrike dhe fusha magnetike kurse në anën e epërme të këtij cilindri, përkatësisht mbi polet magnetike ka elemente të hekurit (shih figurën 13). **Vijon**

Irani: Negociata me ShBA-në vetëm nëse hiqen sanksionet

TEHERAN, 16 KORRIK - Ministri i Jashtëm iranian Mohammed Javad Zarif tha se vendi i tij është i gatshëm të negociojë me Shtetet e Bashkuara, por vetëm nëse ato heqin sanksionet e ashpra ekonomike kundër Iranit. Shtetet e Bashkuara i vendosën sanksionet në vitin 2017 para se

të tërhiqeshin nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015, e cila kërkon që Irani ta ulë pasurimin e uranimit si shkëmbim për zbutjen e sanksioneve. Zarif akuzoi ShBA-në për nxitjen e tensioneve në Lindjen e Mesme duke u shitur miliarda dollarë armë Arabisë Saudite dhe

Emirateve të Bashkuara Arabe, që ai tha se kërcënon programin iranian të raketave balistike. Presidenti Donald Trump e ka quajtur tepër të keqe marrëveshjen bërthamore të vitit 2015. Britania, Kina, Franca, Gjermania dhe Rusia ishin nënshkruesit e tjerë të marrëveshjes.



Dhoma e Përfaqësuesve voton kundër komenteve raciste të presidentit

Udhëheqësi i shumicës demokrate në Dhomën e Përfaqësuesve, Steny Hoyer, tha se do të votojë dhe shpreson që republikanët do ta vënë vendin mbi partinë dhe do të votojnë përkrah demokratëve për ta mbështetur rezolutën që dënon komentet raciste të presidentit Trump

WASHINGTON, 16 KORRIK - Dhoma e Përfaqësuesve, e udhëhequr nga demokratët, do të votojë të martën mbi një rezolutë që "dënon komentet raciste të presidentit Trump", të cilat kishin në shënjestër katër ligjvënës, të gjitha gra me ngjyrë.

Udhëheqësi i shumicës demokrate, Steny Hoyer, e njoftoi votën dhe tha se shpreson që republikanët do ta vënë "vendin mbi partinë" dhe do të votojnë përkrah demokratëve për ta mbështetur rezolutën. Në prag të rezolutës, presidenti Trump i ritheksoi sulmet kundër ligjvënësve Ilhan Omar, Alexandria Ocasio-Cortez, Ayana Pressley dhe Rashida Tlaib. "Ligjvënëset demokrate kanë nxjerrë nga goja ca nga komentet më të ulëta, më të pështira, më të mbushura me urrejtje që mund të ketë thënë ndonjëherë një politikan në Dhomën e Përfaqësuesve dhe Senat, megjithatë u hapet rruga dhe Partia Demokrate i përqafoi", shkruante presidenti në "Twitter". "Komente të tmerrshme kundër Izraelit,

kundër Amerikës, pro-terroristëve dhe fjalë të ndyra në publik, ndër shumë gjëra tronditëse. Por demokratët e tmerruar ia mbatnin nga frika", shkruante presidenti.

Trumpi shtron pyetjen: "Përse nuk voton Dhoma e Përfaqësuesve për t'iu kundërvënë këtyre komenteve të ndyra e gjithë urrejtje? Pasi janë thënë nga e majta radikale dhe demokratët kanë frikë të përballen me to. Sa keq!"

Teksti i rezolutës "dënon me forcë komentet raciste të presidentit Trump, të cilat kanë legjitimuar dhe shtuar frikën dhe urrejtjen ndaj amerikanëve të rinj dhe personave me ngjyrë, duke thënë se bashkëkombësit tanë amerikanë që kanë ardhur si imigrantë dhe ata që mund t'i duken presidentit si imigrantë, duhet 'të kthehen' në vende të tjera, apo termat që u referohen imigrantëve dhe azilkërkuesve si 'pushtues' si dhe komentet që anëtarët e Kongresit, të cilët janë imigrantë (si dhe ata në radhët e kolegëve tanë, të cilët gabimisht supozohet se janë imi-



grantë), nuk e kanë vendin në Kongres apo në Shtetet e Bashkuara".

Sulmet e presidentit Trump kishin në shënjestër ligjvënëset Ilhan Omar, Alexandria Ocasio-Cortez, Ayana Pressley dhe Rashida Tlaib. Të katra ligjvënëset dolën para kamerave të hënën për t'iu kundërvënë komenteve të presidentit ndaj tyre. "Ai ka ndër-marrë një sulm të hapur racist ndaj katër anëtareve të zgjedhura në mënyrë legjitime si deputete në Dhomën e Përfaqësuesve, të

cilat janë të gjitha gra me ngjyrë", tha Omar, një demokrate e lindur në Somali, tashmë shtetase amerikane, e cila përfaqëson një zonë elektorale nga Minesota. "Kjo është agenda e nacionalistëve të bardhë", tha Omar. Dy prej ligjvënësve, Omar dhe Tlaib, të cilat janë gratë e para myslimane të zgjedhura në Kongres, bënë hapur thirrje për hapjen e procesit për shkarkimin e presidentit.

Më parë të hënën, presidenti Trump i ritheksoi komentet që

janë cilësuar si sulme raciste, duke mos përfillur kritikën e shumta se këto komente bien ndesh me vlerat amerikane. "Këto kritika nuk kanë të bëjnë me mua. Shumë njerëz mendojnë si unë", tha presidenti Trump në Shtëpinë e Bardhë.

Trumpi tha në adresë të ligjvënësve: "Nëse nuk u pëlqen këtu, le të largohen, duke shtuar më tej, ato e urrejnë vendin tonë".

Kur u pyet nëse i konsideron këto komente si raciste, presidenti tha "Aspak".

Salvini: Nuk kemi marrë financime të fshehta nga Rusia

ROMË, 16 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Italisë, Matteo Salvini, hodhi poshtë pretendimet se partia e tij populiste është përpjekur të marrë financime të fshehta nga Rusia. Ai ndërkohë ka shtuar komentet në mbrojtje të asaj që e quan "kulturë e krishterë" si dhe për çështjen që e ka shpërblyer më shumë në zgjedhje, emigracionin. Ndërsa prokurorët e Milanos pohojnë se partia e ekstremist të djathtë Lega ka kërkuar

financime të fshehta ruse, zëvendëskryeministri italian ka shtuar komentet e tij anti-emigracion në tubimet dhe në faqet e tij të medieve sociale, duke e lidhur migracionin me krimin dhe papunësinë dhe duke paralajmëruar se kjo është kërcënim për kulturën tradicionale të Italisë.

Kritikët e Salvinit thonë se ai po përpiqet ta largojë vëmendjen nga akuzat për Rusinë dhe nga problemet e ekonomisë së vendit, e cila vazhdon të jetë e


zhytur në recesion.

Pretendimet për financime të fshehta ruse morën një shtysë të re javën e kaluar kur faqja e lajmeve në internet BuzzFeed publikoi audio të një takimi në një hotel të Moskës midis ish-zëdhënësit të shtypit të Salvinit dhe disa rusëve të pidentifikuar duke diskutuar mbi mundësinë e devijimit të 65 milionë dollarëve drejt partisë Lega nëpërmjet transaksioneve të naftës ruse me çmim të ulur.



SHKRIMTARI PËRBALLË DIKTATURËS

Përsiatje rreth librit të shkrimtarit Ismail Kadare,
"Kur sunduesit grinden"



Bedri ISLAMI

Në majin e vitit 1934 një ngjarje e rëndë tronditi Moskën. Një nga poetët më të mëdhenj të vendit, Osip Mandelshtami, është arrestuar. Lajmi, sado i pabesueshëm që mund të dukej, është jo vetëm i vërtetë, por rreth tij sillen gjithfarë hamendjesh, që nga shkaqet më absurde, që shkonin drejt shëmtive të grave, si më të ëmblat dhe njëherësh më të hidhurat në sherrnajat e tyre dhe deri te poezia e tij për "Malokun e Kremlinit", nëntor 1933, e cila, megjithëse e pabotuar dhe as nuk mund të ëndërrohej botimi i saj, ishte tashmë e njohur, pasi poeti, në atë çastin e budallshëm të shpalljes së krijimit të tij, e kishte lexuar mes miqve të shumtë, poetë, si ai. Nga çasti i leximit deri tek arrestimi i tij kishin shkuar veçse disa ditë, çka tregonte se mes dishepujve të poezisë ruse kishte pasur më shumë se sa një Judë, çka ndodh jo rrallë në vendet ku egërsia e shtetit ka gjetur binjakët e vet në egërsinë lakmitare të poetëve. Çështja Mandelshtam merr trajta të çuditshme e të ankthta. Mbi gjithçka sillen hija e keqe, e rëndë dhe mizore e njeriut që mund të kishte urdhëruar këtë arrestim, fijet e të cilit shtrihen në të gjithë atë hapësirë poetike, që mund të quhet miqtë e poetit të arrestuar. Për më tepër, poeti është nga një familje hebraike intelektuale, përherë i dyzuar, mes asaj që i kishte sjellë vrullin i parë përkrahës i revolucionit, dhe përmes këtij vrulli kishin kaluar dy arrestimet e para, kësaj here, që të dyja nga forcat e bardha, dhe, më pas, mendimi i qartë, "për mua s'pyet njeri në botë / As ju, o jetë, o bukuri, / Veç vdekja mundi të më thotë / Ç'jam unë e ç'ëndrra kam në gj", po ashtu me dy arrestime, e kësaj here nga forcat e kuqe, ku i dyti, ai i vitit 1938, në fakt zgjatim i të parit, do të ishte fatkob dhe vrasës për poetin. Mes miqve të poetit ishte edhe Pasternaku, poeti i lirëzuar nga më të shquarit e poezisë ruse, i

brishtë, engjëllor në një çast dhe dashuronjës i lemerisur në çastin tjetër, adhures i "mjedra fletët në argjend do t'i veshë, / kthyer heshtur në degë përmby, / Dielli ballin e fshehur mes resë, / si dhe ti, sibiriankë, e ngrys", poeti që me shkrimin e tij të qartë do i linte shënimin gazetarit legjendë, gjermanit Gerd Ruge se, "kujtimit janë gjithnjë të mijat", që, padashjen e tij, por ngulmueshëm nga të tjerët, bëhet personazhi i tretë i një historie nga më tronditëset e historisë së letërsisë botërore.

Poezia fatale, "Maloku i Kremlinit", e Mandelshtamit është fillesa, por jo fundi i një historie, të cilën e ka sjellë Ismail Kadare në librin e tij të tashëm, "Kur sunduesit grinden".

Është krejt e mundur që "maloku" i Kremlinit të jetë ndërjerë i kënaqur, fillimisht me atë përcaktim aspak naziq, çka ishte dëshira e tij të mos ishte, aq sa ishte e mundur që vetë përcaktori "malok" të mund të përkthehej edhe ndryshe, ta zëmë "Malësori i Kremlinit", si do e përkthente më pas Dritëro Agolli, apo "Kreshniku i Kremlinit" çka mund t'i kenë thënë Stalinit njerëzit rreth tij. Më shumë se ai përcaktim, "malok" atij i bën përshtypje njohja e thellë, jashtëzakonisht e thellë e poetit të natyrës së tij; është si një gërvishje nga brenda dhe shpallje e pabujshme, por reale e asaj që e di fare mirë se ka në vete. Askush nuk ia ka thënë kaq hapur, kaq shkurt e kaq saktë, në vetëm tetë reshta, gjithë çfarë ai përfaqëson dhe gjithë çka mbledhur në vete: "Dhe mustaqja i qesh si i qesh buburrecit/qafë e çizmes si cipë e sedefit. / Qafëhollët drejtues rreth e rrotull i rrinë / të zbavitet me ta si macja me minë. / Qajnë e mjaullijnë e kuisin të gjithë / Veç ai u vërvitet me gisht në turinjte. / Dhe vendimet gatuan me shkrim e me fjalë / njërit plumbin mes syve dhe tjetrit në ballë".

Pas kësaj poezie, Mandelshtami gjithsesi do të rrezohej pa shpresë kthimi në botën e tij të poetit.

Të ringrihej, çka kishte qenë gjithnjë ëndërrzim, pasi e kishte pritur rrëzimin, nuk kishte qenë në dorën e tij, por, po ashtu, do të ishte jashtë tij ajo çka do të

ndodhte disa ditë pas arrestimit gjysmë të beftë, enigma e një telefonate, në ditën e njëzetetretë të qershorit të vitit 1934.

Në ciklonin e ngjarjes do të ishin tre vetë: Mandelshtami i arrestuar, i cili përsëriste në birucën e padritshme në Lubjanka, provat që kishte bërë me mikun e tij besnik, Arkadij Furmanov, njeriun që lozte rolin e hetuesit, duke ndërjerë pranë vetes arrestimin; Josif Visarianoviç Stalini, shefi i madh i Kremlinit, për të cilin sapo u kishte lexuar miqve të tij poezinë kobndjellëse, mes të cilëve edhe Pasternakut, dhe, ky i fundit, poeti i brishtë, i cili kishte edhe ai mëkatet e tij, që, pasi nuk ishte mjaftuar vetëm me poezitë e tij për netët e dimrit, e kishte përshkruar njeriun e hekurt, si një xhuxh me trup katërmbëdhjetëvjeçari dhe fytyrë burri vjetran.

Ndërsa për të parin, Stalini e dinte me siguri se kishte bërë poezinë makabër për të dhe joshëse për kundërshtarët e tij, për poetin tjetër, Pasternakun, ndonëse mendohej se nuk dinte asgjë për poezinë që dukej e zhdukej si mjegull, dinte edhe më shumë për shpirtin, që mund të thyhej që në kërcitjen e parë e, po ashtu, ishte i bindur se, nëse ai do të thyhej, do të merrte mbi vete edhe shumë nga gjynahet e tij.

Ismail Kadare sjell këtë hapësirë të pafundme, si një rreth dantesk, më saktë, në trembëdhjetë rrethe danteske, torturues dhe rrënues njëkohësisht, të cilat përmbliidhen fillimisht në një bisedë treminutëshe, për të dalë në një fushëpamje shumë të panjohur, por të llogaritur deri në detajet më të imta, për të krijuar mitin e rremë të legjendës së lënies në baltë të shokut, aq më tepër të braktisjes së poetit nga poeti, të mendimit të lirë nga një tjetër mendim i lirë, të shkëndijimit të idesë nga një tjetër shkëndijim dhe, në fund të fundit, të krijimit të asaj që ishte dëshira më e madhe, sunduesi është më i mëshirshëm se sa poeti. Ndërsa poeti hesht, sunduesi trishtohet; nëse poeti nuk ka kurajon për të thënë të vërtetën, sunduesi sjell kohën e tij, të bolshevikëve të vjetër, që kurrë nuk e braktisën njëri tjetrin; ndërsa sunduesi kërkon të hapë një portë lirie, poeti hesht dhe e mbyll këtë portë. Kjo legjendë mjerane është menduar gjatë, ndoshta që para arres-

timit të Mandelshtamit, edhe më tej në kohë, që kur u bë leçitja e Dantes nga Firenze, edhe më tej akoma, që kur u bë ndeshja e parë mes poetit dhe shtetit, lirisë dhe diktaturës. E hershme dhe tragjike është kjo ndeshje.

Një temë e përbotshme, të cilës Ismail Kadare i është kthyer e rikthyer me ngulm, gati të pabesueshëm, duke gjetur brenda vetes dhe për t'i përcjellë drejt nesh si kumte të pashmangshëm, të cilët, edhe pse fillimisht duheshin deshifruar, një ditë do të ishin qartësisht të dukshme. Për poetin në diktaturë ka gjithnjë një kohë kur ai pyet veten: do të jem me shtetin apo kundër shtetit. Me askënd nuk mund të jesh. Paanësia mund të ishte kudo tjetër, por jo në një shtet diktatorial. Përballjet e hapura ishin aq të pakta sa dukej se ishin një histori pamundësisht, por edhe shkrepimash.

Në çdo kohë do të kishte përballje të tilla. Shpesh herë arti është thirrur për t'i shërbyer shtetit dhe pak herë shteti është ngritur për t'i bërë strehë artit. Për të gjetur një strehëz duhej të paguaje haraçin tënd. Ja, edhe ai, i pandalshmi i kësaj ngjarjeje, Mandelshtami, historia e të cilit do të kishte ngjashmëri fatale me shumë poetë, ish të burgosur politikë në Shqipëri, pak dekada më pas, kishte shkruar një herë një varg besnikërie, "Unë, komunisti, pa parti", si të donte të siguronte një devizë besimi, të cilin e kishte pasur një kohë, kur pas studimeve në Universitetet e Sorbonës, Heidelbergut dhe të Sankt-Petersburgut, ndoshta i shtyrë nga ndjenja kalorsiake, u dha fuqishëm pas lëvizjes revolucionare.

Nëse në këtë histori janë fillimisht tre vetë, Kadare bëhet i katërti i tyre. Por, krejt haptas, ai i bashkohet dy kolegëve të tij poetë, dhe, megjithëse duket i vonuar, kumti i librit të tij, "Kur sunduesit grinden" është më shumë se sa një kumt i zakonshëm poetik. Në fakt, është vazhdim i përsiatjes së tij, mesazhi se asgjë nuk duhet të humbasë nga ajo që ka ndodhur dhe, për ta zvogëluar këtë humbje, e cila është herë-herë e pashmangshme në rrjedhë të viteve, ka vetëm një mënyrë: duhet njohur e ndaluar, e pamundura dhe risjellë ajo.

Këtë bën Ismail Kadare, por edhe kjo atij nuk i është dukur e mjaftueshme.

Çdo njeriu historia i fal një ndje-

si të veçantë dhe një përjetësi të vogël, e cila i lejon atij të shohë të kaluarën, por edhe të ardhmen e tij të afërt.

Stalini nuk i ka zgjedhur rastësisht dy personazhet e tjerë të kësaj historie. I ka zgjedhur sipas përcaktimit të tij satanist, por edhe që të jenë shërbenjës në të ardhmen. Mandelshtami duhet të paguajë për herezinë e tij, Pasternaku duhet të bëhet alibia e mosfajit të diktatorit. Që nga momenti i arrestimit të poetit nuk kanë shkuar veçse pak ditë, por ata kanë qenë të mjaftueshme për të bërë gati gjithë atë që do të ndodhte më pas. Ose gjithçka ka qenë e përgatitur mjeshtërisht që më parë dhe ditët e mbetura në hapësirën kohore arrestim - telefonatë, i kanë shërbyer për t'i dhënë dorën e fundit.

Pasternaku është rritur në një mjedis fluid. Nëna e tij hebreje, pianiste dhe e dashuruar pas Rubinshtejnit, njëjtë si nëna e Mandelshtamit, shpesh herë depresiv dhe i pagjumë, i lodhur nga jeta në një banesë ku shumë gjëra ishin të përbashkëta, naiv deri në dhimbje, natyrë e mënjanoj, i ftohtë ndaj njerëzve, por adhures i Majakovskit, të cilin, po ashtu do e mohonte, i thyer në shpirt dhe i thyeshëm në bindjen e tij njerëzore. Pra, i llogaritur me detaje, duke shtuar këtu edhe emrin si poeti i parë i Rosisë.

Si për ta parë gjithçka më tragjike dhe më të pranuar, ashtu si tek Makbethi, me shfaqjen e magjistriceve në fillimin e gjithçkaje që do të trondisë botën, edhe këtu, në këtë tre minutësh, shfaqet një tjetër - hije, kësaj here hija e Stalinit, që do të ikë më pastaj së bashku me të zotin e tij.

Është Poskrebishevi. Sekretari i Stalinit. Njeriu hije i tij. I frikshëm, megjithëse i padukshëm. Ai shfaqet i pari. Ismail Kadare nuk e harron këtë "magjistrice", pasi, gjithë ajo që ka ndodhur nuk mund të perceptohet pa këtë, "gëzuash Pasternak, poeti i parë i vendit, rrofsh romancier, i pari nobelist që do të vritesh nga çmimi i lakmuar, i dashuri i Olga Ivinskaja - Larës shemër të pangjashme me asnjë shemër tjetër, përshëndetje bashkeshorti grabitës i Zinaida Neuhaus, urime Boris, përkthyes, prozator e eseist që nesër do të jesh në gojë të përbotshme".

(Vijon në numrin e ardhshëm)

E jashtëzakonshme

Etiopia gati për rekord botëror, synon mbjelljen e 4 miliardë pemëve

Kryeministri i Etiopisë, Abiy Ahmed, ka ndërmarrë një mision që synon mbjelljen e katër miliardë pemëve në të gjithë vendin. Etiopia është vendi i dytë më i populluar i Afrikës. Projekti do të vihet në zbatim gjatë sezonit të shiut. "Gjatë viteve të fundit sipër-



faqja e pyjeve në Etiopi është zvogëluar dhe ne kërkojmë ripyllëzimin kombëtar me 40 pemë për kokë", ka njoftuar zyra e kryeministrit të Etiopisë.

FOTO E DITES



Anijet e peshkimit në bregun e Liqenit Malavi në fshatin Senga. /AFP/

E rrallë

Rruga që hyn në rekordet e Ginesit si më e pjerrëta në botë

Një rrugë ka hyrë në librin Gines si më e pjerrëta në botë. Ffordd Pen Llech ndodhet në veri të Uellsit. Banorët në Harlech festuan për hyrjen e rrugës në Guinness World Records pasi u veri-



fikua pjerrtësia e saj prej 37.45 për qind. Rekordi mbahej nga Baldwin Street në Dunedin, Zelanda e Re, me një gradient prej 35 përqindësh në pjesën më të madhe të saj.

BARSOLETA E DITËS



Pacienti: Doktor, a shkoj mirë operacioni?

Doktori: Miku im, unë jam engjëlli.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00

“X-Men; Dark Phoenix”

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray




Ne ora 22:00

“M A”

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Ankthi që kishit për ditën e sotme do të zvenitet shumë shpejt. Pa e menduar do të arrini të mbaroni punë që në orët e para të ditës.</p>	 <p>DEMI Jeni të shqetësuar se çfarë do të ndodhë me një problem të caktuar tuajin, por nuk e kuptoni që po i fusni vetes energji negative pa ndodhur asgjë.</p>	 <p>BINJAKËT Nëse mendoni që sot duhet t'ju realizohet gjithçka pa bërë asnjë lëvizje, gaboheni rëndë. Impenjohuni nëse doni të keni rezultate.</p>	 <p>GAFORRJA Edhe pse një ditë e zakonshme ju nuk bini asnjëherë pre e rutinës, por dini si të organizoni takime dhe aktivitete që ju vënë në lëvizje.</p>	 <p>LUANI Keni mjaft opsione interesante sot për ta kaluar ditën dhe nuk dini kë të zgjidhni. Miq të duan një ditë në natyrë dhe vendi do t'ju pëlqejë pa masë.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Ilaçi i ditës suaj sot do të jenë blerjet. Ata që ju shoqërojnë do të kënaqen sepse ju bëni shumë dhurata.</p>
 <p>PESHORJA Sot jeni ju protagonistët e situatave të ndryshme që jua ofron dita. Do të dini t'i bëni zgjedhjet e duhura.</p>	 <p>AKREPI Edhe pse dita do të jetë shumë e rrëmujshme, mbrëmja paraqitet e qetë dhe në shoqëri të mirë.</p>	 <p>SHIGJETARI Partneri nuk do të kuptojë një takim pune që do t'ju dalë sot papritur. Debate dhe zënka parashikohen gjatë pasdites.</p>	 <p>BRICJAPI Keqkuptimet që do të lindin së fundmi nuk do të ndodhin për shkakun tuaj kështu që nuk keni pse të ndiheni fajtor.</p>	 <p>UJORI Mos qëndroni të mbyllur në shtëpi sot. Dita është shumë e bukur dhe duhet shijuar në çdo çast. Do kërkon shoqërinë e një miku.</p>	 <p>PESHQIT Sot çdo gjë duket sikur shkon sipas planit dhe nuk do të ndiheni të rrezikuar aspak nga një koleg që ju ka vënë shkopinj nën rrota.</p>


Angelina e zënë me punë, Bradi do të kalojë më shumë kohë me fëmijët e tij



Brad Pitti që një kohë ka luftuar që të kalojë sa më shumë kohë me fëmijët e tij që nga ndarja me Angelina Jolien. Ai më në fund do ta arrijë këtë verë dhe do të jetë bashkë me ta. "Angelina do të kalojë verën duke filmuar skenat e filmit të ri 'Those

Who Wish Me Dead', prandaj kjo do t'i ofrojë më shumë kohë Bradit për t'u kujdesur për fëmijët. Ky është një hap i madh për të dhe fëmijët, të cilët e kanë pasur ta kufizuar kohën e tyre me babanë e tyre, që nga ndarja e prindërve", raporton "The Sun".

Soulja Boy lirohet nga burgu



Soulja Boy, emri i të cilit është DeAndre Cortez Way, është liruar nga burgu të dielën në orën 1:57 të mëngjesit. Arsyeja për lirimin e tij citohet si "përfundim",

që do të thotë se koha e tij ka përfunduar. Reperi u lirua nga burgu pasi shërbeu vetëm 94 ditë burgim nga 240 ditë sa ka pasur, raporton "Page Six".



I dështon koncerti në Nju Jork, Lopezi lë hotelin me peshqir në kokë

Dy net më parë Jennifer Lopezi ka ndërprerë koncertin e saj në Nju Jork për shkak të rrymës elektrike. Fansat e saj patën mundësi të dëgjojnë vetëm katër ose pesë këngë të idhullit të tyre. Por Lopezi nuk i

ka zhgënjyer adhuruesit e saj. Ajo përmes një videoje në rrjetet sociale ka treguar se koncerti i saj do të mbahet të hënën. Këngëtarja seksi është parë me një peshqirë në kokë teksa ka lënë hotelin e saj në Nju Jork.

Post Malone nis turneun në shtator



Artisti 24-vjeçar Post Malone ka njoftuar se turneu i tij në Amerikën Veriore nis gjatë këtij viti. Sipas tij, gjithçka do të nisë

më 14 shtator në Tacoma dhe më pas në ShBA dhe Kanada, me ndalesë në Las Vegas më 22 shtator dhe në Dallas më 2 nëntor.

Vanity Fair: Shqipëria, Majemi i Mesdheut; njerëzit mbajnë dorën në zemër për të të falenderuar



Gazetarja Raffaella Serini i kushton një artikull, të botuar në faqen internet të revistës prestigjioze “Vanity Fair” për Italinë, bukurive të Shqipërisë dhe arsyeve përse duhet që turistët e huaj të kalojnë pushimet në vendin tonë.

“Një vit më parë, Shqipëria ishte një bast i fituar. Këtë vit mund të jetë një fitore e sigurt. Të kthehesh për vitin e dytë radhazi, për pushime, është një garanci, kjo është përgjigja me e saktë për ata që pyesin vazhdimisht: Ke qenë në Shqipëri, si është atje?”, shkruan Serini.

Të mendosh që një verë më parë, nuk ekzistonte as “Lonely Planet” që të jepte garanci mbi

Shqipërinë (vetëm një libër shumë i mirë i botuar nga “Morellini”), edicioni i parë italian i kësaj guide të famshme udhëtimeve doli vetëm në maji të vitit 2018.

Thënë këtë, mes shumë rrugëve në një udhëtim krejtësisht origjinal, bazuar në sugjerimet e atyre që kanë qenë më parë dhe konsultimet e forumeve të udhëtimeve, surprizat nuk kanë munguar. Sepse asgjë nuk të linte të parashikoje deri në fund atë që do kisha zbuluar, bukurinë e peizazheve, ende të egra dhe të pandotura, detin e shkëlqyeshëm, mikpritjen e njerëzve, si dhe çmime shumë të ulëta.

Sigurisht, elementi që tërheq

më shumë nga Shqipëria është deti, me siguri që ai nuk do ju zhgënjëjë. Megjithatë, nuk është i vetmi motiv për të kaluar pushimet këtu. Tirana është një kryeqytet plot gjallëri dhe interesant, Vloca është si Majemi i Mesdheut (harrojmë imazhet e atyre varkave që në vitet '90 niseshin nga këtu), Butrinti është një park i vërtetë arkeologjik.

Më pas, mbi të gjitha, janë njerëzit. Që ende mbajnë dorën në zemër për të falënderuar. Në rast se porosit një kafe në lokalit e tyre, por nëse ekspresi nuk punon, dalin dhe e marrin në lokalit në krah. Jo të gjithë flasin italisht sikurse pritet (por flasin edhe anglisht). Por ata që

dinë, shpesh të thonë: “E kam mësuar duke parë Italia Uno!”. Një herë, pronari i një bari ku qëndrova për të ngrënë mëngjes nuk fliste anglisht dhe nuk kuptonte çfarë doja të porosisja. Kështu që thërriti djalin për ta ndihmuar në përkthim. Djali, nuk kishte mbushur ende tetë vjeç (në faturën që më dorëzoi, kishte përkthyer me laps çdo gjë që kisha porositur...).

“Për sa i përket ushqimit, gatimi në Shqipëri është i shkëlqyer (madje edhe pica dhe kafeja ekspres!). Arsyeja e kësaj kuptohet menjëherë, pasi përbërësit janë të freskët dhe të gjithë ata që sot operojnë në sektorin e restoranteve, me shumë mundësi kanë punuar, si emi-

grantë, në restorantet më të mirë në Itali dhe Europë, kështu që kanë sjellë në atdhe eksperiencën e tyre dhe përzierjen më të mirë të gastronomisë. Në një lokal pak më larg Vlorës, për shembull, njoha Vilin, një djalë që gjatë verës menaxhon hotelin e tij të vogël që bie direkt mbi det, ndërsa në dimër është barist në një hotel me pesë yje në Luksemburg. Nëse do ju thoja se i tiji ishte “Spritz” (koktejl me verë) më i mirë që kam provuar ndonjëherë jashtë kufijve të Italisë, a do më besonit? Epo ju them se duhet”, mbyll artikullin Serini me një thirrje për gjithë turistët e huaj që të vijnë në Shqipëri gjatë pushimeve të tyre.

Doni të blini makinë të përdorur? As mos e provoni pa mësuar këto hile

Kilometrat e përshkuara janë shpesh shigjeta e peshores. Mund të rastisë që gjen rishitësa apo persona që shesin makinën e tyre, që “fusin dorë” në kilometrazh për ta “rinuar” makinën. Por duhet të mësosh të shohësh sinjale të tjera që tregojnë gjendjen e makinës.

Karroceria

Kontrollo që karrocERIA e makinës të mos ketë ndryshk. Verifiko mbylljen e deryve e të kofanos dhe shiko nëse boja e makinës është homogjene pasi makina mund të ketë pësuar aksident nëse lyerja nuk është e njëtrajtshme.

Gomat

Nëse janë shumë të konsumuara, vlera e makinës duhet ridiskutuar. Po ashtu,

nëse gomat janë konsumuar në mënyra jouniforme, atëherë kjo mund të tregojë se makina ka defekte të tjera si p.sh në frenim.

Pjesa e brendshme dhe kroskoti

Nëse timoni është i konsumuar, është e mundur që makina të ketë më shumë se 100 mijë kilometra. Kontrolllo që të ketë airbag apo Abs. Provoni të përmbysni sediljen e parë dhe verifikoni nëse punojnë butonat dhe komandat.

Motori dhe mekanika

Hap kofanon dhe kontrolllo nëse ka lëngje apo vajra të derdhura dhe që bateria nuk është e gjërryer e që testata nuk filtron vaj, shkruan Scan. Për një kontroll të pjesëve më delikate të motorit nevojitet një kontroll në ofiçinë.

Bëj një xhiro provë shumë të kujdesshme

Është shumë e rëndësishme që të bësh një xhiro në rrugë me makinën që dëshiron të blesh, mundësisht të shoqëruar nga një mekanik i besuar.

Gazi që shkarkon

Pasi ndizet dhe ngrohet motori, pasi disa minutash provo të shtypësh gazin deri në fund. Nga skapamentoja nuk duhet të dalë tym me ngjyrë blu, sepse kjo tregon se motori djeg vaj, në rastin e motorëve me benzinë ose tym i zi që tregon se injektorët e filtrat janë të bllokuar, në rastin e motorëve me naftë.

Zhurma e motorit

Duhet të jetë, në limitet e mundura, sa

më pak i zhurmshëm. Përndryshe është simptomë e problemeve me marmitën ose me sistemin e shkarkimit.

Pjesët elektrike

Kontrollo funksionimin e dritave, pasqyrave, dritave të brendshme e llambave të tjera të kroskotit.

Marshet

Duhet të futën lehtësisht dhe për asnjë arsye nuk duhet të ndryshojë nëse nuk janë të pozicionuara në shinën e duhur.

Loja e timonit

Timoni nuk duhet të ketë zona “të vdekura” gjatë ecjes. Nëse gjatë rrotullimit timoni reagon pak, mund të jetë që kutia e drejtimit duhet rishikuar.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kosova debutoi me humbje në Botëror

U21-shat e Kosovës kanë debutuar me humbje në Kampionatin Botëror pasi janë mposhtur nga Kroacia me rezultat 26:17. Pavarësisht prej humbjes, hendbollistët "dardanë" kanë pasur paraqitje të mirë ndaj një kundërshtari shumë të fortë, i cili synon triumfin në këtë garë. Të martën humbje ka pësuar edhe Përfaqësuesja U19 e femrave nga Çekia 32:10



U19, që me ndeshje të nivelit të lartë besojmë se do ta ngrehin nivelin dhe në të ardhmen do të kenë prezantim më të mirë.

Besa, Kastrioti dhe Istogu mësojnë kundërshtarët në Evropë

Prishtinë, 16 korrik - Tri skuadrat që e përfaqësojnë hendbollin e Kosovës në garat

ndërkombëtare, Besa Famgas dhe Kastrioti në konkurrencën e meshkujve dhe Istogu në konkurrencën e femrave, kanë mësuar të martën kundërshtarët për garat evropiane. Kampioni i Kosovës në hendboll, Besa Famgas, në raundin e parë kualifikues të Kupës së EHF-së do të përballet me skuadrën zvicerane Pfadi Winterthur. Ekipi pejan ka një përvojë të madhe në garat

evropiane, pasi ka arritur deri në raundin e dytë, por përvojë të madhe ka edhe skuadra nga Zvicra.

Përballja e parë mes këtyre dy skuadrave pritet të zhvillohet më 31 gusht ose 1 shtator, ndërsa e kthimit një javë më vonë. Fitues i Kupës së Kosovës në hendboll në konkurrencën e meshkujve është skuadra e Kastriotit. Skuadra nga Ferizaj do të paraqitet në Kupën Sfiduese (Challenge Cup), kurse kundërshtare e ka skuadrën Dukla Praha nga Çekia. Kastrioti ndeshjen e parë e zhvillon si vendës më 5 ose 6 tetor, ndërsa ndeshjen e kthimit e zhvillon më 12 ose 13 tetor. Ndërsa kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave, Istogu, nuk ka pasur shumë fat në shortin që është hedhur në Vjenë të Austrisë, pasi kundërshtarë në ndeshjen e rrethit të parë të EHF Cup do ta ketë skuadrën bjelloruse, Gomel. Ndeshja e parë zhvillohet më 7 ose 8 shtator në Gomel, kurse ndeshja e kthimit më 14 ose 15 shtator në Pejë.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës U21 në hendboll ka debutuar me humbje në Kampionatin Botëror që po mbahet në Spanjë. "Dardanët" janë paraqitur mirë, por kanë pësuar humbje nga Kroacia me rezultat 26:17. Pjesa e parë e Kosovës ka qenë mjaft e mirë, duke e ruajtur dallimin me kroatët dhe kjo pjesë u mbyll me rezultat 14:11, por edhe në pjesën e dytë kundërshtari i "dardanëve" të rinj e shfrytëzoi përvojën dhe me tri gola dallim e fitoi këtë pjesë, kurse rezultati i përgjithshëm i kësaj ndeshje ishte 26:17. Duhet cekur se transmetimi i kësaj ndeshje u

paraqit pa flamuj shtetërorë, ani pse në ndeshjet e tjera janë paraqitur me flamujt shtetërorë. Ndeshjen e radhës Kosova e zhvillon të enjten me Hungarinë, derisa të premtën takohet e Portugalinë. Të dielën takohet me Brazilin dhe të hënën me Bahrejin. Ndërsa paraqitje shumë të zbehtë ka pasur Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll (femrat) në ndeshjen e dytë në Kampionatin Evropian, Divizioni B që po mbahet në Lituani. Kosova pësoi humbje nga Çekia me rezultat të lartë, 32:10. Ndeshjen e fundit në kuadër të Grupit A Kosova e zhvillon të enjten ndaj Ishujve Faroe. Është kjo edhe një ndeshje e vështirë për vashat

Sermaxhaj, trajner i U19-shave te Drita

GJILAN, 16 KORRIK - Ish-futbollisti i njohur në Kosovë, Genc Sermaxhaj, është emëruar trajner i ekipit U19 në skuadrën e Dritës. Sermaxhaj si futbollist ka pasur një karrierë të pasur ku, përveç Dritës dhe Gjilanit, ka luajtur edhe për Fushë-Kosovën dhe Prishtinën. "Pas një viti të suksesshëm me grupmoshën U15, të FC Drita, tani jam emëruar trajner i ekipit të Juniorëve U19 për sezonin e ri 2019/20. Jam i lumtur me postin që më është besuar dhe premtoj se do të bëj më të mirën nga vetja ime për sukseset e reja. Falënderoj klubin dhe koordinatoren e shkollës për besimin që kanë në mua, kolegët e mi trajnerë të cilët kanë bërë dhe bëjnë punë të mirë me moshat dhe lojtarët me të cilët do të kemi bashkëpunim për sezonin vijues, duke iu dëshiruar shëndet dhe suksese", ka thënë Sermaxhaj.



Dajaku: Jam i lumtur që mund të luaj për Bayernin

MUNCHEN, 16 KORRIK - Sulmuesi me origjinë shqiptare, Leon Dajaku, është lojtar i ri i skuadrës së Bayern Munchenit. 18-vjeçari ka nënshkruar kontratë me skuadrën e Bayernit deri në vitin 2023. Sulmuesi i kombëtares gjermane U18 është planifikuar për ekipin e dytë, kurse sezoni i ri nis edhe zyrtarisht në fundjavë. "Jam mjaft i lumtur që do të mund të luaj për Bayernin në të ardhmen dhe dua ta jap kontributin tim për sezonin e ardhshëm", ka thënë Dajaku, i cili e ka veshur fanellën e Kombëtares së Gjermanisë për të rinj plot 17 herë, 14 herë me ekipin U-17 dhe tri herë për U-18. Edhe drejtuesit e gjigantit bavarez e kanë shprehur gëzimin e tyre që tash e tutje do ta kenë në



dispozicion futbollistin nga Kosova. Ata besojnë se Leoni do të bëhet lojtar i madh. "Jemi mjaft të lumtur që Leoni e ka zgjedhur Bayernin", ka thënë Jochen Sauer, kreu i FC Bayern Campus. "Ne jemi të bindur se ai do ta bëjë një përparim të madh në Bayern", ka shtuar ai.

Shkëndija eliminohet nga Liga e Kampionëve

TETOVË, 16 KORRIK - Shkëndija është eliminuar nga Liga e Kampionëve pasi u mposht

1-2 në ndeshjen e kthimit nga Kalju. Fitorja në Estoni (0-1) nuk i bëri shumë punë

ekipit të drejtuar nga Qatip Osmani, pasi në fushën e vet u mposhtën 1-2 nga ekipi

uellsian, që kalon në raundin tjetër. Për Shkëndijën shënoi Ibrahimimi nga penall-

tia, kurse për mysafirët shënuan Maximiliano Ugge dhe Liliu.

Broja: Besojmë në kualifikim

TIRANË, 16 KORRIK - Mesfushori Ron Broja iu bashkua Partizanit në këtë afat kalimtar. 23-vjeçarit iu besuan 22 minuta në sfidën e parë të Ligës së Kampionëve ndaj Qarabagut, tekta në një prononcim për "Supersport", Broja u shpreh optimist dhe beson se

skudra e tij mund t'ia dalë në Baku. Gjithashtu, futbollisti nga Mitrovica ka thënë. "Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë. E dimë se çfarë force ka Qarabagu. Ne jemi përgatitur shumë mirë dhe besojmë se mund të kualifikohemi. Falënderoj trajnerin që

më dha rastin të luaj disa minuta. Besoj se do të kem më shumë hapësira. Ky është vetëm fillimi dhe u ndjeva mjaft mirë në fushë. Është skuadër e madhe Partizani. Besoj se edhe këtë vit do të shpallemi kampionë", ka thënë Broja.



Mulaomerviq: Japim maksimumin ndaj Britanisë dhe Luksemburgut



PRISHTINË, 16 KORRIK - Basketbollistët e Kosovës janë duke zhvilluar stërvitjet për t'u përgatitur sa më mirë për parakualifikimet e "Eurobasket 2021". Stërvitjet do të vazhdojnë dy herë në ditë, kurse gjatë fundjavës "Dardanët" zhvillojnë dy miqësore me Sllovakinë në udhëtim. Në stërvitjen e së hënës në mbrëmje i pranishëm ishte edhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu. Ai ka konfirmuar se FBK-ja gjithmonë do të jetë afër lojtarëve dhe stafit, derisa shtoi se pret që basketbollistët të japin 100 % nga vetja për Kosovën, ashtu siç e

kanë dhënë deri më tani. I pari i basketbollit kosovar nënvizoi se ndeshjet ndaj Luksemburgut dhe Britanisë së Madhe janë shumë të rëndësishme, kurse u uron fat dhe suksese lojtarëve në këto ndeshje. Ndërsa përzgjedhësi i Kosovës, Damir Mulaomerviq, beson se do të përgatiten maksimalisht. "Do të kemi edhe dy ndeshje miqësore që do të na ndihmojnë të përgatitemi sa më mirë. Shpresoj se nuk do të kemi lëndime dhe të përgatitemi sa më mirë deri para ndeshjeve të gushtit", ka thënë Mulaomerviq për faqen zyrtare të FBK-së. Trajneri Mulaomerviq foli edhe

për kundërshtarët e Kosovës. "Jemi në grup me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe. Nuk do të jetë lehtë, por edhe ne kemi gjasat tona. Luksemburgu ka një ekip për respekt, derisa do të shohim se me çfarë ekipi do të paraqitet Britania. Sidoqoftë, ne do të japim maksimumin dhe angazhimi ynë nuk do të mungojë", ka shtuar Mulaomerviq. "Dardanët" më 3 gusht janë mysafirë të Luksemburgut, më pas e presin Britaninë e Madhe më 7 gusht dhe Luksemburgun më 14 gusht, kurse ndeshja e fundit është kundër Britanisë në udhëtim më 17 gusht.

Real Madridi e kërkon Kosovare Asllanin

MADRID, 16 KORRIK - Kosovare Asllani mund ta vazhdojë karrierën në futbollin spanjoll. Për futbollisten që shkëlqeu në Kampionatin Botëror të Futbollit për Femra me Suedinë, interesim ka shfaqur Real Madridi. Kosovare Asllani mund t'ua shohë hairin paraqitjeve të shkëlqyeshme që i bëri në Kampionatin Botëror të Futbollit për Femra. Në fakt, futbollistja kosovare shkëlqeu në eventin që u mbajt në Francë në fanellën e Suedisë, me të cilën e fitoi medaljen e bronzit. Madje, mediat e huaja e vlerësuan atë si futbollisten më të mirë të këtij të këtij turneu. Prandaj, mediat suedeze shkruajnë se futbollistja nga Kosova ka marrë ofertë nga ekipi Deportivo Tacon, i cili nga sezoni 2020/2021 do të quhet Real Madrid. Klubi madrilen ia ka



ofruar një kontratë solide 29-vjeçares, e cila do të largohet këtë verë nga Linkopings FC, klub tek i cili luan që nga viti 2017. Në të kaluarën, Asllani kishte luajtur edhe në Paris Saint-Germain dhe

Manchester City. Tacon është inkuadruar sivjet në elitën e futbollit spanjoll për femra dhe po mundohet të organizohet sa më mirë dhe ta bëjë një ekip të fortë për edicionin e ri.

SHKURT

Griezmanni: Messi është numri një në futboll

Transferimi i ri i Barcelonës, Antoine Griezmann, e vlerësoi Leo Messin si lojtarin numër një në lojën e futbollit. "Ai është numri një në futboll, ashtu siç është LeBron në basketboll. LeBroni është imazhi i basketbollit dhe i NBA-së. Në të njëjtën mënyrë është edhe Messi, imazhi i futbollit. Ka diçka ndryshe nga lojtarët e tjerë, diçka që ndodh një herë në 30 vjet", ka thënë Griezmanni.

Interi 'harron' Lukakun, synon Zapatan

Interi ka hequr dorë nga transferimi i sulmuesit të Manchester Unitedit, Romelu Lukaku, pasi skuadra angleze kërkon 80 milionë euro. "Corriere Dello Sport" raporton se tash synim i Interit është sulmuesi i Atalantës, Duvan Zapata, i cili ka shkëlqyer në edicionin e fundit duke shënuar 23 gola në 37 ndeshje.

Coutinho, afër rikthimit në Liverpool

Transferimi i Griezmannit dhe mundësia për ta rikthyer edhe një herë Neymarin ka bërë që braziliani Philippe Coutinho ta mendojë largimin nga Barcelona. 27-vjeçari mund të rikthehet në Premierë Ligë, pikërisht tek ekipi që ka luajtur edhe para se të transferohet në Liverpool. "Reds" do të paguajë 88 milionë paund për brazilianin. Futbollisti brazilian preferon rikthimin në Liverpool para kalimit në PSG.

Delphi nga City në Everton

Evertoni e ka transferuar Fabian Delphin nga Manchester City. 29-vjeçari nuk ishte zgjedhja e parë për trajnerin Pep Guardiola, që firmosi për 3 sezone me ekipin e ri, ndërsa u bashkua menjëherë në Zvicër për fazën përgatitore. 9.5 milionë euro arkëtoi Manchester City për kartonin e Delphit, ndërsa 1.7 milion euro do të jenë bonuse, në bazë të numrit të ndeshjeve që do të luajë titullar.

PSG-ja njofton Barçën se Neymari nuk shkëmbehet

Paris Saint-Germain është i vendosur të kërkojë 222 milionë euro plus bonuse nga Barcelona nëse dëshiron të nënshkruajë me Neymarin. "AS" njoftoi të martën e kaluar se katalanasit, të cilët janë të prirë për ta rikthyer brazilianin përsëri në 'Camp Nou', kishin paraqitur një ofertë me vlerë 40 milionë euro plus Philippe Coutinho dhe Ousmane Dembele. Por, PSG-ja nuk është e interesuar për shitjen e 27-vjeçarit për më pak se 222 milionë euro, shifra që ata ranë dakord t'i paguajnë Barçës për ta marrë atë fillimisht në vitin 2017.

Kameruni shkarkon Seedorfin

Eliminimi nga 1/8-at e Kupës së Afrikës i ka kushtuar shtrenjtë trajnerit të Kamerunit, Clarence Seedorf. Ish-mesfushori i Milanit është shkarkuar nga drejtimi i kombëtares afrikane. Emërimi i Seedorf në krye të Kamerunit, me ndihmësholan-dezin tjetër Patrick Kluyvert, u konsiderua një surprizë. Ai zëvendësoi trajnerin belg Hugo Brus, i cili e udhëhoqi Kamerunin drejt lavdisë në Kupën e Afrikës në vitin 2017. "Kam folur me presidentin në lidhje me dispozitat e kontratës, pasi ekipi ynë kombëtar ka bërë një lojë monotone, jo efektive dhe të lexueshme lehtë. Nuk kemi një lider real dhe eliminimi nga Kupa e Afrikës, ka vërtetuar paaftësinë e trajnerit tonë duke mos arritur ta mbajë grupin dhe disiplinën. Kështu, arritëm në përfundimin se ai nuk është për këtë punë", ka thënë ministri i Sportit i Kamerunit, Narcisse Mouelle Kombia.



EPOKA E RE		Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA NË FOTO	METODË STUDIMI	KRYENGRITËS QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT	KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK	QË SAPO ËSHTË PËRGATITUR	ISMET TOTO	FJALA E DHËNË PËR DIÇKA	SHKRONJA VIII & XXII	DËSHIRË E MADHE PËR TË MARRË VESH A PËR TË MËSUAR DIÇKA	EPOKA E RE	VLERË E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT
		SËMUNDJE E FËMIJËVE QË SHFAQET ME SHTRËMBËRIMIN E ESHTRABE										BASHKËT. JAPAN AUTOMOBILE FEDERATION	
		FJALA TINGULLIM-ITUESE											
		FALJE FETARE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT (pashq.)						BASHKËT. 3.14 (Mat.)		RRALLË (Lat.) NDESHJET			
		KËNGËTARJA ... FARA PARIA E SHOQËRISË				MBISHKRIM NË NJË GUR VARRI (shq.) ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER							
							KULACË VARG I KURANIT					TROPOJA KËNGËTARJA SOKOLI	
		KLUB FUTBOLLI NË HOLANDË ... ALKMAAR			NAIM ABAZI LLOJ PIJE ALKOOLIKE			ILAZ KODRA AGIM TEJECI			FINLANDA, ESTONIA NËNNDARJA E NJË LIGJI		
		FATKEQËSIA E MADHE, KOBË							MËRI, ZILI PARA TË NËNTIT				
EPOKA E RE	MBATHËSE SPORTIVE	TRAJNERI ITALIAN SAKI	AKTORJA HOLLMUDIANE BASINGER	TUNIZIA, UGANDA	ZANORE	ARMENIA	PËRHAPJE E VALËVE (sh.shq.) KRYEQYTËTI I JORDANISË						KËNGËTARI VLLASALIU (shq.)
ALEANCA						PJESË E KËMISHËS (sh.shq.) MURI I NDËRTUAR ME DËRRASA			DISIPLINË SPORTIVE LLOJ REVOLEJE				
BISHË MALI					PJESËTAR I NJË POPULLI NË SRI LANKË FENERI			PREMTIMI SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK PESHORE ME DY PJATA					
PORTIERI AMERIKAN ... HOWARD (EVERTON)				FATALIZËM AKTORI YNË ADRIAN						SHTET NË AZI E JUGUT	AKTORJA SUEDEZE MARGRET UNITED NATIONS		
ISMAJL GAGICA			FLOTA DETARE SIGURËSA ELEKTRIKE					KITARISTI ANGLEZ KLEPTON (shq.) MËNJANIM NGA GARA				ZANORE MA JEP	
VARG AUTOMJETESH (shq.)						ISLANDA ZANORE	"EPOKA ... " ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR KOLA			BASKETBOLLISTI TURK OMER ISH BOKSIERI YNË LIKA			
ZANORE		LLOJ QERREJE KUAJSH MURG I VETMUAR				BLETËRRITËS ELIZA DUSHKU					BREJTËS I VOGËL FILOZOF GREK		
EPOKA E RE	DRAMË E SANTORIT LLOJ LËNDE PLASËSE (shq.)					KËNGËTARJA MARKU NYJË							PËRPJEKJE PËR TA VRARË NË VEPRIMTAR TË SHQUAR
MJET UDHËTIMI (shq.)						ISH BASKETBOLLISTI HABIB PËREMËR VETOR			HAJDE ALENSANDRO NESTA				ZANORE EDI RAMA
DRAMATURGU ARBËRESH JOSIP					SHKRONJË TË NJËJTA PATRICK PETERSON		KAM DIJENI PËR DIÇKA SHTET NË AFRIKË		SHUMË I MADH. GOXHA DIJETAR FETAR MYSLIMAN				
GRIMCOVA (bised.)			FIJE E HOLLË PAMBUKU RRRITJE E SASISË			TËRËSIA E NORMAVE TË SË DREJTËS ZAKONORE AKTORI ... GIBSON					KUNDREJT E VJETËR I DHUROJ		
TAJVANI, INDONESIA			SHABAN POLLUZHA KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK		AKTORJA E NJOHUR STRIP BASHKËT.				FILLOJ TEDI ALVES				NANTES PËRGJIGJE NË TELEFON
PEZMATIM I VESHIT					NJËSI MONETARE BAZË E JAPONISË TONI ADAMS			AKTORI AMERIKAN ... DAMON (shqip.) DY BASHKËTINGËLLORE		LLOJ VETURE ITALIANE SELEN			
TË LËMUARIT (pashq.)	LEGJENDË BASHKËT.				KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM TREVISO			NGASËSI I "FORMULA 1" FELIPE TROYES			NOTË MUZIKORE INTER		
TERRITOR I IMAMIT						KËNGËTARJA ... BAJRAMI			KONGRES-ENI AMERIKAN ENGEL				



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall:*

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Divizioni për zbatimin e projekteve
Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e për menaxhimin e projekteve dhe objekteve arsimore (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 16.07.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyrë kontratat për renovimin dhe ndërtimin e ndërtesave arsimore;
- Mbikëqyrë regullimin e infrastrukturës përcjellëse të ndërtesave arsimore për projekt -dizajne;
- Bashkëpunon me komunat dhe donatorët e jashtëm për ruajtjen e efikasitetit të energjisë në shkollat;
- Asiston divizionin e prokurimit të MASHT-it dhe divizionin e financave sipas nevojës në administrimin e obligimeve në kuadër të MASHT-it;
- Mbikëqyrë implementimin e planifikimeve të hapsirave shkollorë të administruara nga MASHT-i, nga komunat dhe donatorët, duke u siguruar që janë respektuar normat e planifikimit;
- Asiston në përgatitjen e paraqitjes së buxhetit dhe raporteve tjera të nevojshme financiare dhe punon programin e investimeve kapitale, PIP.

Kualifikimet

- Diploma universitare në arkitekturë -projektim, apo ndonjë fushë e përafërt; dy (2) vite përvojë pune në arkitekturë, menaxhim të projekteve, dizajne etj;
- Rishikon donatorët, komunat dhe planet e kontraktorëve dhe sigurohet që planet e tyre janë në përputhje me planifikimin e hapësirave shkollorë si në MASHT;
- Bën monitorimin e shpenzimeve të fondeve që janë të alokuara në komuna, që të sigurohet që planifikimi i hapësirave shkollorë janë në pajtueshmëri me projektet specifike të MASHT-it;
- Njohuri në kompjuter duke përfshirë Word, Excel, Auto CAD, arch Cad etj;
- Njohuri në gjuhët e huaja në anglisht dhe gjuhën serbe.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 23.07.2019 .

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në uebfaqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo, Zakon br. 03/L-149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja nauke i tehnologije objavljuje:*

Konkurs "Sporazum o posebnim uslugama"

Institucija: *Ministarstvo obrazovanja nauke i tehnologije*

Departament: Divizija za implementaciju projekata
Plata bruto: 423.47 €

Naziv radnog mesta: Službenik za menadžiranje projektima i obrazovnih institucija (1 radno mesto)

Vreme trajanja ugovor: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Dat:** 16.07.2019

Zadaci i odgovornosti

- Nadgleda ugovore za renoviranje i izgradnju obrazovnih objekata;
- Nadgleda regulisanje prateće infrastrukture obrazovnih objekata za projekte-dizajne;
- Sarađuje sa opštinama i spoljnim donatorima za očuvanje energetske efikasnosti u školama;
- Pomaže departamentu nabavke MONT-a i diviziji za finansije prema potrebi u administriranju obaveza u okviru MONT-a;
- Nadgleda implementaciju planiranja školskog prostora koje administrira MONT, opštine i donatori, obezbeđujući da su ispoštovane norme planiranja
- Pomaže u pripremi budžetske prezentacije i drugih potrebnih finansijskih izvještaja i radi na program kapitalnih investicija, PIP.

Kvalifikacije

- Univerzitetna diploma arhitekture - projekt, ili bilo koja približna oblast, Dve (2) godine radnog iskustva u arhitekturi, menadžiranje projektima, dizajnu, itd;
- Pregledava donatore, opština i planove ugovarača i osigurava da njihovi planovi budu u skladu sa planiranjem školskim prostorom kao u MONT-u;
- Vrši monitoring troškove sredstava dodijeljenih opštinama kako bi se osiguralo da je planiranje školskih prostora u skladu sa specifičnim projektima MONT-a;
- Poznavanje rad na kompjuter uključujući Word, Excel, Auto CAD, Arch CAD itd;
- Poznavanje stranih jezika na engleskom i srpskom jeziku.

Uslovi za učesće na konkurs

Pravo na apliciranje imaju svi punoletni državljani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, da imaju potrebno obrazovanje i stručnu sposobnost da obavljaju dužnosti i koji imaju fizičke veštine koje se zahtevaju za određenu poziciju.

Dat zatvaranje konkursa: Konkurs je otvoren 7 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Dat zatvaranje konkursa 23.07.2019

Kandidati aplikacije (obrazac za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/> ili da dobiju u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Ul. "Agim Ramadani" br. 1 u kancelariji arhive, gde takođe i dostavljaju popunjene aplikacije.

U prilog aplikacije morate priložiti: Kopija lične karte, kopija dokumentacije o kvalifikaciju kao i ostala dokumenta potrebna u skladu sa konkursom.

Zahtevi poslati nakon isteka krajnjeg roka neće se primati Zbog velikog broja pristiglih prijava kontaktiraće se samo kandidati koji su ušli u uži izbor.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 16. 07. 2019

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës Nr.03/L212, Udhëzimit Administrativ(MPMS) NR.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik shpallë:

KONKURS

1. Një (1) Bashkëpunëtor shkencor për fundin e shek. XX - zgjedhje
2. Një (1) Hulumtues i pavarur për shek.XVI-XVIII - zgjedhje
3. Dy (2) Hulumtues të pavarur për shek.XX - zgjedhje/rizgjedhje

1. Kandidati për pozitën Bashkëpunëtor shkencor për fundin e shek.XX (pozita nr.1) duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencës për periudhën përkatëse,
- Të ketë të botuar së paku një punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër lemisë,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Njohja e gjuhës së huaj është përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve të doktoraturës,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

1. Kandidatët për pozitën Hulumtues i pavarur (pozita 2 dhe 3) duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoraturës për periudhën përkatëse,
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore nga periudha e caktuar,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Njohja e gjuhës së huaj është përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Vërtetimin për vijimin e studimeve të doktoraturës
- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (MA),
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512 - 303, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, pa numër (Ndërtesa e re e Institutit; afër Institutit Albanologjik të Prishtinës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 16. 07. 2019

1. Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013), Član 30, Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 33 stav 5, član 51 i 52 obavljuje, Zakon Br. 03/L-212 o Radu, Administrativno Uputstvo (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, objaviti:

KONKURS

2. 1 (Jedan) Naučni saradnik za kraj XX vekove – izbor
3. 1 (Jedan) Nezavisna istraživač za XVI-XVIII vekove- izbor
4. 2 (Dva) Nezavisni istraživači za XX vekove- izbor/reizbor

1. Kandidati za Naučnog saradnika za kraj XX vekove (položaj br.1) moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje jedan (1) naučnih rad objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti,
- Sudjelovali su u znanstvenim aktivnostima u zemlji i inozemstvu.
- Poznavanje stranih jezika je prioritet.

Potrebna dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu za završetak doktorskih studija,
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.

2. Kandidati za Nezavisna istraživač (položaj br. 2 i 3) moraju ispuniti ove uslove:

- Upisane doktorske studije za navedeni period.
- Objavljene radove u naučnim časopisima iz navedenog perioda;
- Da su učestvovali u naučnim aktivnostima u zemlji i u inostranstvu.
- Poznavanje stranih jezika je prioritet.

Potrebna dokumentacija:

Kandidati treba da dostave sledeću dokumentaciju:

- Potvrda koja dokazuje da pohađa doktorske studije,
- Diploma za završetak relevantnih studija (MA)
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.

Izbor osoblja Instituta Istorija "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L - 135 za istraživačke- naučne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri".

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira. Kandidati izabrani na izbornoj listi će biti obavješteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br. Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu : Institut Istorije u Prištini, bez broja (Novi Objekat u blizini Instituta Albanologjik i Prishtinës)



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"



Ref. Nr.

Pejë,

NJOFTIM

Për anulimin e konkursit

Anulohet konkursi nr. 1860, i dt. 12.07.2019, më marrëveshje për shërbime të veçanta për pozitat: Zyrtar për Çështje Mësimore dhe Sigurim të Cilësisë.

Me respekt:

Zyra e Personelit e UHZ - së

Adresa: Rr. "UÇK-së" 30000 Pejë

www.unhz.eu ; E-mail: info@unhz.eu ; Tel. : +381/39/423 270



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Besart Halimi" B.I. shpallë të pavlefshme dokumentet e biznesit me nr. 71167011.

► Alban Miroci shpallë të pavlefshme diplomën fakultetit të Shkencave Politike në Kolegjin "FAMA" në Prishtinë me numër të protokollit: 492\0716.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshohet lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshohet banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshohet banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

KONKURS

EDUKIDS NË FERIZAJ, SHPALL KONKURS:

- Edukatore - 3 vende të lira;
- Motër Edukatore - 3 vende të lira;
- Kuzhinierë - 1 vend i lirë;
- Pastruese - 1 vend i lirë.

Për të qenë pjesë e EduKids në Ferizaj, ju duhet t'i plotësoni këto kushte dhe kritere:

- Edukatore dhe motër edukatore
Të keni të kryer Fakultetin e Edukimit (Drejtimi Parashkollor, Pedagogji);
Të keni të kryer Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;
Drejtimi i Pediatrisë; Drejtimi Mamisë ose edhe Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi Infjermeri (vlen vetëm për motër edukatore);
Përvojë pune;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar, energjikë dhe emocionalisht të gatshëm për t'u përballuar me situata emergjente;
Të njihni mirë psikologjinë dhe botëkuptimin e fëmijeve;
Të jepni ndihmën e parë në rastet emergjente.

• Kuzhinierë

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me stafin dhe fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

• Pastruese

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

Kandidatet e interesuara duhet të kompletojnë dokumentet:

- CV;
- Diploma dhe çertifikatat e trajnimeve (nëse keni);
- Dëshmitë mbi punët paraprake (nëse keni punuar më herët);
- Çertifikata e lindjes.

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në adresën: edukids05@gmail.com
Për info shtesë, kontaktoni EduKids +383 45 714 713 (viber&whatsApp)
KONKURSI MBETET I HAPUR DERI MË 31 KORRIK 2019

Vetëm kandidatet e kualifikuara do të ftohen për intervistë



KONKURS

- Edukatore** - 3 vende të lira
- Motër Edukatore** - 3 vende të lira
- Kuzhinierë** - 1 vend i lirë
- Pastruese** - 1 vend i lirë

CV-të e kompletuara me dokumentet e kërkuara të dërgohen në: edukids05@gmail.com deri në datën **31 Korrik 2019**

Për info shtesë, kontaktoni: **+383 45 714 713**

